

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVIII i botimit, nr. 210, Prill 2021  
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## 80 vjetori i Luftës së Gurit të Kuq kundër ushtrisë Jugosllave 2



## NË SHKOLLËN 9 VJEÇARE "DEDË GJON LULI" HOT I RI PUNOHET ME MOTON: MËSIM DHE EDUKIM 4

Shtysë për të ju rikthyer së shkruari për shkollën 9 vjeçare "Dedë Gjon Luli" Hot i Ri u bë zënia e kësaj shkolle të vendit të parë në shkallë republike të konkursit "Shkolla e shekullit 21" organizuar nga "British Council" nën kujdesin e ambasadës Britanike, ku morën pjesë 625 shkolla nga i gjithë vendi, doli në finale midis 10 shkollave dhe paraqitja e shkollës së Hotit me "Komuniteti im" u vlerësua me vendin e parë.

## GJON DUKGILAJ, "Mjeshtër i Madh" 8

### BASHKËBISEDIM ME PRONARIN E BAR-RESTORANT-HOTEL "TRADITA-GEGE&TOSKE"-

Biznesmeni, pronari i Bar-Restorant-Hotel "TRADITA", Gjon Duggilaj, me propozim të Presidentit të Shoqatës së Restoranteve të Shqipërisë, zoti Kujtim Dervishi, me datën 7 prill 2021, në Presidencë i jepet dekorata e lartë "Mjeshtër i Madh", nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Ilir Meta, me motivacion: "Për arritjet e tij të suksesshme në fushën e kulinarisë, turizmit etnokulturor dhe agroturizmit në trevën e Shkodrës. Me aftësi të larta administrative në harmonizimin e artit të gatimit për ruajtjen e vazhdimin e trashëgimisë sonë të pasur etnografike, kostumeve autentike dhe banesës karakteristike shqiptare". Me këtë dekorim "Mjeshtër i Madh", u vlerësua puna e palodhur e dy dekadave të këtij dukagjinasi të palodhur për të shpalosur në çdo kohe vlerat dukagjinase.



## KRYENGRITJA E PA DËSHIRUAR E VITIT 1911-të 6

Kjo kryengritje për vetë rëndësinë përmasat dhe misionin e pa përfunduar është nga ngjarjet më të shumë përshkruara dhe më të shumë kënduara të fillim i shekullit të lirisë. Një proverb universal që ishte kryefjalë edhe për Sami Frashrin thotë: "Është turp të gënjesh bashkëkohësit, është krim të gënjesh ata që vijnë pas nesh, prandaj shumica e historianëve janë kriminel!".

Mendja ime, me bindje më thotë se për këtë ngjarje është orvatur më shumë se duhet, për të mbuluar disa gjera që duhen thënë shkurt dhe troç. Nga ngjarjet e mëdha dhe te vlefshme historike gjithkush do të përfitoj kapital, prandaj qoftë heshtja, qoftë tendenca revizionuese janë abuzime manipuluese për mendjet dhe shpirtet e pasardhësve.

## ZEF MALA, PËR GJERGJ FISHTEN DHE G JUHËN SHQIPE (VITI 1955) 10

Unë, Zef Mala, kam manifestue dhe kam qenë kundër faktit që një poet i madh si Fishta të braktiset në një anë vetëm për shkak të ideve të tij. Unë mendoj se përgjithësisht në letërsi dhe në art më shumë se personaliteti i artistit, ka rëndësi vepra e tij.

- Fishtën unë e konsideroj si poetin më të mirë të gjuhës shqipe që i ka kapërcyer kufijtë e Shqipërisë dhe të Ballkanit dhe zëvend midis poetëve më të mëdhenj evropianë të shekullit tonë. Do të vijë një kohë që Fishta do të rehabilitohet (viti 1955)

- Unë në artin kërkoh më tepër formën në të cilën është paraqitur se sa përmbajtjen. Për mua përmbajtja është më e rëndësishme se forma.

# 80 vjetori i Luftës së Gurit të Kuq kundër ushtrisë Jugosllave

Me datën 11 prill 2021, Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, organizoi një takim përkujtimor për 80 vjetorin e Luftës së Guri i Kuq kundër ushtrisë Jugosllave. Një ngjarje e pa trajtuar, por një luftë që ka hyre në histori si “Lufta e çuditshme”.

- Me 8 prill 1941, 800 forca Jugosllave kalojnë qafën e Valbonës dhe futen në Theth,

- 19 mijë forca kalojnë nga qafa e Agrit - Vuksanaj -Kodër Shëngjergji.

- Me 9 prill konfrontimi në Qafë të Astërs me ushtarët italian

- Me 10 Prill 700-800 forca nisen drejt Gurit të Lekës dhe Qerretit, pjesa tjetër stacionohet në Fusha të Gjata. Ushtria detyron banoret t’u sjellin ushqim e tagji për kafshë.

Me 10-15 prill ushtria fillon grabitjet masive,

- 15 prill vriten 5 martirët e Dardhës.

- Natën dhe mëngjesin e 22 dhe 23 prillit katastrofa fatale në shtegun e Gurit të Kuq (vetën këtë natë të tmerrshme kemi një ndeshje të pastër Shqiptare-Jugosllave vriten qindra e qindra serbo- malazezët dhe gjithë ushtria në fund dorëzohet!

Në këtë veprimtari morën pjesë familjaret e të rënëve dhe të plagosur në këtë luftë, të atyre që morën pjesë në këtë luftë, përfaqësues të miqve, si shoqata “Mirëdita”, dega Shkodër, z. Zef Gjini; të shoqatës Atdhetare



“Malësia”, z. Ilmi Kurti, të ftuar kandidat për deputet, që prej atyre të ftuar morën pjesë, zonja Jona Leqezja e Pal Shkambi. Sigurisht në këtë veprimtari ra në sy mungesa e administratorëve të Njësisë Administrative të zonës së Dukagjinit.

Hapi veprimtarinë Kryetari i SHAD, z. Ndue Sanaj, ligjëroj për 80 vjetorin e Luftës së Gurit të Kuq, historiani dhe autori i librit, me titull “Lufta e

Çuditshme”, kushtuar kësaj ngjarje luftarake, Prele Milani dhe ligjëroj poeti Lulash Brigja. Përhëndeten Dr. Mark Palnikaj, kandidati për deputet i pavarur z. Pal Shkambi, kryetari i shoqatës atdhetare “Malësia”, z. Ilmi Kurti. Pastaj u ndanë titujt e nderit për ata që kane dhënë jetën dhe janë plagosur në këtë luftë. Veprimtaria u mbyll me fjalën përkatëse nga z. Ndue Sanaj.

Në këtë veprimtari përkujtimore, me vendim të kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, u nderuan me titullin “**Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini**”, të gjithë të masakruarit e të varrosurit për së gjalli nga ushtria Jugosllave, si: Martin Pali i datëlindjes 1862, fshati Nica; Zef Delia i datëlindjes 1898, fshati Nica; Dede Vuksani i datëlindjes 1901, fshati Gurre; Deli Sokoli i datëlindjes



1867, fshati Gurre dhe Pjeter Delia, 1907, fshati Gurrë, me motivacion: **“Shpirti Juaj prehet në zemrën e Atdheut, për t’i dhënë atij oksigjenin e përjetësisë, në faqet e arta të historisë dukagjinase dhe kombëtare”**; të gjithë ata që dhanë jetën në këto luftime, si: Pal Mirashi i datëlindjes 1897, fshati Brashte; Kole Qerimi i datëlindjes 1917, fshati Çilikok; Pal Kola i datëlindjes 1906, fshati Palaj; Nike Delia i datëlindjes 1921, fshati Ndragjinaj; Vat Prele Pepa i dendjes 1889, fshati Kir; Pëllumb Gjoni i datëlindjes 1883, fshati Xhan; Nike Sokoli i datëlindjes 1883, fshati Mgull; Pjeter Ndou i datëlindjes 1908, fshati Quke-Shale; Grimc Ndou i datëlindjes 1909, fshati Lotaj; Zef Gjergji i datëlindjes 1917, fshati Gjonpepaj-Nikaj; Gjon Tahir Neçaj i datëlindjes 1922, fshati Peraj-Merturi; Gjok Sadrria i datëlindjes 1919, fshati Palç-Merturi; Martin Zhivani i datëlindjes 1918, fshati Curraj i Poshtëm-Nikaj; Mhill Hajdari i datëlindjes 1922, fshati Qerret-Temail; Zef Toma i datëlindjes 1884, fshati Plan-Pult dhe Zenel Shaban Ymeri, fshati Ura e Shtrenjtë, me motivacionin: **“U flijuat në emër të Lirisë, Sovranitetit e Vlerave më të çmuara njerëzore, duke u bere udhërrëfyes të brezave në vijimësi, dhe duke u skalitur në memorien e tyre, si korifenj e Patriotizmit Dukagjinas”**; si dhe të plagosurve në këto luftime, si: Lulash Deda, fshati Lotaj; Gjoke Mirashi, fshati Vuksanaj; Lulash Ndrethi, fshati Çilikok; Dode Nika, fshati Ndreaj; Gjon Pal Leka, fshati Xhan; Pal Mark Zeqiri, fshati Palçi; Vat Çuni, fshati Brisë; Dede Marku, fshati Prekal; Zef Marku, fshati Mgulle, me motivacion: **“Ngadhënyet fitimtar, mes barotit, flakës së luftës, duke dale faqebardhe në një rën nga betejat më të përgjakshme që është zhvilluar në historinë dukagjinase, ndaj meritoni pasaportën e trimërisë dukagjinase”**.

Ata, që kane dhënë jetën në këto luftime me ushtrinë



Jugosllave, dhe konkretisht: Martin Pali i datëlindjes 1862, fshati Nica; Zef Delia i datëlindjes 1898, fshati Nica; Dede Vuksani i datëlindjes 1901, fshati Gurre; Deli Sokoli i datëlindjes 1867, fshati Gurre dhe Pjeter Delia, 1907, fshati Gurrë; Pal Mirashi i datëlindjes 1897, fshati Brashte; Kole Qerimi i datëlindjes 1917, fshati Çilikok; Pal Kola i datëlindjes 1906, fshati Palaj; Nike Delia i datëlindjes 1921, fshati Ndragjinaj; Vat Prele Pepa i dendjes 1889, fshati Kir; Pëllumb Gjoni i datëlindjes 1883, fshati Xhan; Nike Sokoli i datëlindjes 1883, fshati Mgull; Pjeter Ndou i datëlindjes 1908, fshati Quke-Shale; Grimc Ndou i datëlindjes 1909, fshati Lotaj; Zef Gjergji i datëlindjes 1917, fshati Gjonpepaj-Nikaj; Gjon Tahir Neçaj i datëlindjes 1922, fshati Peraj-Merturi; Gjok Sadrria i datëlindjes 1919, fshati Palç-Merturi; Martin Zhivani i datëlindjes 1918, fshati Curraj i Poshtëm-Nikaj; Mhill Hajdari i datëlindjes 1922, fshati Qerret-Temail; Zef Toma i datëlindjes 1884, fshati Plan-Pult dhe Zenel Shaban Ymeri, fshati Ura e Shtrenjtë, kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me vendim nr. 261, dhe numer protokollit 1434, date 8 prill 2021, strukturave vendim-marrëse i ka propozuar për t’u dhënë statusin e “Dëshmorë të Atdheut”

**Lavdi dëshmorëve të atdheut!**

Kjo veprimtari u mbështet nga z. Gjon Dukgilaj, pronari i bar-restorant e hotel “TRADITA”; avokati dhe sekretari i shoqatës z. Anton Kosteri, N/Kryetari i shoqatës z. Gjergj Leqejza e Agron Hasanaj dhe nga pronari i Bar-Restorant “Çikago”, z. Genc Çardaku, të cilët i falënderojmë dhe “Paçin e dhëncin!”

Faleminderit atyre që respektojnë historinë!

Faleminderit atyre që mundësojnë për të ruajtur dhe trashëguar artin dhe kulturën!

**Lulash Brigja,  
Shkodër,  
më 11 prill 2021**

# NË SHKOLLËN 9 VJEÇARE "DEDË GJON LULI" HOT I RI PUNOHET ME MOTON: MËSIM DHE EDUKIM

Shtysë për të ju rikthyer së shkruari për shkollën 9 vjeçare "Dedë Gjon Luli" Hot i Ri u bë zënia e kësaj shkolle të vendit të parë në shkallë republike të konkursit "Shkolla e shekullit 21" organizuar nga "British Council" nën kujdesin e ambasadës Angleze, ku morën pjesë 625 shkolla nga i gjithë vendi, doli në finale midis 10 shkollave dhe paraqitja e shkollës së Hotit me maketin "Komuniteti im" u vlerësua me vendin e parë.

Maketi ishte ndërtuar me shumë deti, në të cilin paraqiteshin të gjitha pasuritë natyrore, si ato ujore, bimësinë dhe shprehnin idenë se si t' i mbrojmë ato dhe si t' i vëmë në shërbim të komunitetit, duke bërë përpjekje maksimale për eliminimin e përmbytjeve, ruajtjen e faunës e florës nga dëmtimet dhe të gjitha problematikat e përditshme që komuniteti ka. Si fillim ishte hedhja e ideve me punën në grup duke nxit tek nxënësit aftësitë kritike të menduarit, që nxënësit të punojnë në mënyrë krijuese dhe të mësojnë në mënyrë argëtuese, interaktive e inovative dhe në fund u konkludue me maketin "Komuniteti im". Për këtë maket punuan nxënësit, Marin Dedvukaj, Antonio Malshyti, Daniel Dedvukaj, Erenis Miri, Maria Pllumbaj, Endri Kodraçaj, Mateo Sylja dhe David Marku, të drejtuar e udhëhequr nga mësuesja pasionante e informatikës dhe shkencave natyrore, Jasmina Bajraktari. Ndhimesën e tyre dhanë edhe mësuesja e anglishtes, Vitore Kodra dhe ajo e gjuhë-letërsisë, Jehona Quku.

Konkurruan online dhe puna e tyre u paraqit nga nxënësit, Antonio Malshyti dhe Marin Dedvukaj si dhe mësuesja, Jasmina Bajraktari. Këtij suksesi të shkollës së Hotit të Ri i bënë jehonë mediat lokale në Shkodër dhe ato qendrore, ku, TV "TOP CHANNEL" dha një minutazh të veçantë në emisionet e mbas ditës. Shpalljen si shkollë fituese e bëri Zv/Ministria e arsimit, znj. Nina Guga, e cila falënderoj shkollat për punën e bërë, sidomos atë të shkollës 9 vjeçare "Dedë Gjon Luli" e Hotit të Ri Shkodër, e cila ka nderin që të përfaqësojë Shqipërinë në konkursin që zhvillohet në shkallë Evropë.

Ky sukses i fundit i shkollës 9 vjeçare Hot i Ri, është në vijimësi të arritjeve që kjo shkollë ka pas nga viti në vit, në të gjitha veprimtaritë kulturore, artistike apo sportive ku ka marrë pjesë, në ato lokale apo kombëtare, e cila në të gjitha është vlerësuar me kupa apo medalje, duke filluar që në vitin 2004 në Shurdhah, ku grupi i shkollës së Hotit të Ri mori kupën e festivalit folklorik midis shkollave të qarkut Shkodrës, duke vazhduar me veprimtaritë e zhvilluara në Anën e Malit, në festivalin e lojërave popullore

duke zënë çdo vit vende nderi. Edhe në veprimtaritë sportive, në vitet 2015-16-17, kjo shkollë ka zënë vend të parë bazë njësie administrative Rrethina. Kjo tregon për punën e mirë që kanë bërë mësueset e edukimit muzikor dhe edukimit fizik, duke mos mohuar edhe ndihmesën e pakursyer të mësuesve të tjerë të shkollës.

Për çdo veprimtari kulturore e artistike brenda e jashtë shkollës detyroheshin t' i merrnin ku të mundnin veshjet tradicionale me qere, që kishin problematikat e tyre. Për ta eliminuar këtë dukuri, në shkollë

lindi iniciativa që këto rrobat kombëtare t' i prodhonte e vetë shkolla në mënyrë artizanale. Mbas një pune intensive disa mujore nga mësueset: Vitore Kodra, Drita Zefi, Tule Ahi e Liçe Gjellaj u arrit që të bëhen 11 palë rroba tradicionale për djem e vajza, gjithçka me forcat e veta, të cilat hynë në inventarin e shkollës dhe i përdorin kur të ju nevojiten pa pasur nevojë me ja shtrirë dorën askujt. Për këtë punë të mrekullueshme, unike në llojin e vet që meriton për t' u marrë shembull, dhanë ndihmesën e tyre edhe mësueset:

Flora Pali, Marie Buxha dhe Katrina Ndou.

Arritjet e kësaj shkolle janë shumë dimensionale. Që në pamjen e parë të jep menjëherë përshtypjen se këtu mësohet dhe edukohet. Një mjedis i jashtëm dhe i brendshëm i mrekullueshëm për t' u pas zili. Bimë të shumëllojshme për hije, dekorative si dhe lule të shumëllojshme në oborr, në korridore e klasa me shumicë dhe shumë të mirëmbajtura. Korridoret të mbushura me punimet e nxënësve në artet pamore e figurative duke shfrytëzuar



Nga e djathta ne te majte: Antonio Malshyti- nxënës, Gjovalin Kodra- Drejtori i shkollës, Jasmina Bajraktari-mësuese, Aimir Osmani-mësues dhe Marin Dedvukaj- nxënës.



Nga e djathta ne te majte, nxënësit Antonio Malshyti, Danijel Dedvukaj, Marin Dedvukaj, Mateo Sylja, Renis Miri

mjetet rrethore si, guaska deti, shumë deti apo letër me vizatime e shumëngjyrëshe e cilësore, pjesë e disa konkurseve brenda shkollës.

Aty janë të ekspozuara tabela të ndryshme me nxënës të dalluar, qeveri e senat të nxënësve, mësues të kësaj shkolle në 22 vitet e ekzistencës së saj, kënde me planet e shkollës afatshkurtër e afatgjatë e të tjera. Në stenda të ndryshme paraqitet qartë e estetikisht historiku i shkollës dhe e fshatit, me figurat kryesore të arsimit apo historisë nga Hoti, që ndikojnë në edukimin patriotik e atdhetar të nxënësve.

Këtu punohet mirë me librin. Ka një bibliotekë të pasur me libra të shumëllojshme, sidomos për fëmijë, e cila shfrytëzohet vazhdimisht nga nxënësit për lexime jashtë klasë apo për kulturë, ku në këtë drejtim bën një punë të lavdërueshme mësuesja e letërsisë,

Jehona Quku.

Edhe për këtë shkollë primare ka qene dhe është mësimi. Ka një trupë mësimore me një përgatitje të lartë shkencore e metodike, pjesa më e madhe me shumë vite pune aty, të cilët tashmë e kanë formuar personalitetin e tyre dhe kanë fituar respektin e nxënësve dhe të bashkësisë. Ecet me plane mësimore të hartuara në kohë e cilësisht dhe bëhen përpjekje maksimale për t'u dhënë jetë në procesin mësimor, ku bashkë me përgatitjen sistematike ditore, ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e asimilimit të njohurive shkencore nga nxënësit, duke bërë që analfabetizmi funksional të jetë pothuajse zero, gjë e cila nuk ndodh në shkollat e tjera. Edhe drejtorja e shkollës ecën me plane mujore, vjetore dhe afatgjata të hartuara cilësisht dhe shumë konkrete, duke pas parasysh kushtet dhe specifikën e shkollës dhe bëhen përpjekje sistematike për zbatimin e tyre, duke ndikuar në rritje e rezultateve në procesin mësimor-edukativ, rezultate të cilat kanë pasur progres nga viti në vit. Për arritjet e kësaj shkolle, apo edhe të shkollave të tjera, nuk kanë asnjë meritë strukturat lokale apo qendrore të arsimit, sepse ka dekada që mungon kontrolli i tyre për të parë se si është cilësia e të nxënësve nga ana e nxënësve, por janë kthyer në

burokrat shkresash e formularësh të ndryshëm, të cilët shkollën e kanë kthyer në eksperimente si të Pavllovit. Për arritjet e kësaj shkolle në kompleksitetin e tyre meritë ka kolektivi pedagogjik, të cilët i karakterizon ndërgjegjia e përkushtimi në punë, duke vënë mbi gjithçka interesat e shkollës si dhe drejtimi me kompetencë e profesionalizëm nga drejtuesit e shkollës, Gjovalin Kodra e Tule Ahi.

Në këtë shkollë zbatohen me fanatizëm këshillat për pandeminë covid-19 si: matja e temperaturës çdo ditë, ruajtja e distancës, ku është e mundur, mbajtja e maskave si dhe higjiena e pastërtia, që në këtë drejtim rol determinant ka luajt ujtë e bollshëm, që shkolla ka në ambientet e brendshme e të jashtme të saj, si rezultat i lidhjes së ujit me ujësjellësin e fshatit dhe një shpimi të bërë në oborrin e shkollës. Kjo ka bërë që asnjë mësues apo nxënës nuk është deklaruar me covid.

Për arritjet dhe sukseset e kësaj shkolle meritë të veçantë ka drejtori, z. Gjovalin Kodra, i cili me aftësitë e



Nga e djathta në të majtë, nxënësit Antonio Malshyti e Marin Dedvukaj

tij drejtuese, ka ditur të vërë kolektivin në punë, duke zbatuar me rigorozitet rregulloren e brendshme dhe ligjet për

arsimin para universitar, duke gjetur gjuhën e mirëkuptimit me mësuesit si dhe duke udhëhequr me shembullin personal. Ka ditur të përfitojë nga bashkëpunimi me pushtetin vendor dhe shoqata të ndryshme sidomos me "Word Vision" që kanë kontribuar në rregullimin e ambienteve të brendshme të jashtme, në riparimet e ambienteve dhe orendive apo pasurimin e bazës material. Edhe mësuesit, për nevojat e shkollës kanë kontribuar financiarisht sidomos mësuesi Aimir Osmani nëpërmjet kancelarisë "Osmani", pronar i të cilës është, si në bazën kompjuterike, kancelarina të ndryshme apo material didaktike. Jam shpresëplotë se, edhe në të ardhmen arritjet e shkollës "Dedë Gjon Luli" Hot i Ri do të jenë akoma më të mëdha në gjithë procesin mësimor – edukativ, duke qene si gjithnjë në pararojë të shkollave të qarkut Shkodër e më gjere.

Prelë Shytani, prill 2021

# Një adolishent në familje

- Vizion nga numerin i kaluar -

Adoleshenti që të përballojë këto trazira asnjëherë më shumë se në këtë moshë ka nevojë për dorën e ngrohtë të familjes, kjo është mbrojtja më e mirë në këto momente. Përshtatshmëria në disa raste do të ishte e mirë, p.sh. në disa momente babai po t'i përshtatet djalit kjo do të sillte "zbutjen" e situatës të krijuar nga vetë adoleshenti. Pastaj me kalimin e kohës do të gjendet rruga e zgjidhjes. Shprehja «Të kam djalë, por ama tani ti je rritur dhe të kam edhe shok», i jep zemër që ai të konsiderojë shok dhe kështu ai tek babai gjen dhe shokun që në këto momente ka nevojë që të bisedojë për të fshehtat e tij. Kështu ai nuk do të pritej në besë nga ndonjë tjetër shok i moshës së tij i cili ka problemet e veta dhe nuk është i aftë që të jetë foleja e djalit tënd. Në këtë rast vajzat janë më të befasuara nga tradhtia e shoqes dhe këtu zë fill një inat që do t'i duhet shumë përpjekje për ta shkukur nga mendjet e tyre këto inate të kësaj moshe. Në këtë rast dhe në të tjera raste të këtij lloji nënë në veçanti duhet ti qëndroj afër. Ajo duhet të jetë inteligjente dhe të hetoj shqetësimet që vajza e saj po shfaqë në këtë periudhë. Është detyra e nënës që ti qëndroj afër vajzës dhe ti thotë se tani ajo është e rritur dhe duhet të flisni bashkë si dy shoqe.

Adoleshenca është në kuptimin e vërtetë të fjalës një tranzicion prej varësisë te pavarësia dhe përfundon, kur individi arrin statusin e të rriturit. Ne do të përshkruajmë shkurt disa nga ndryshimet e rëndësishme të zhvillimit që ndodhin në

adoleshencë.

Gjatë adoleshencës ndodhin gjithashtu shumë ndryshime të tjera si p.sh. rritja e vullshme. Si djemtë ashtu edhe vajzat përjetojnë një rritje të vullshme gjatë adoleshencës, gjë që shfaqet në mënyrë të dukshme në peshën dhe gjatësinë e tyre. Te vajzat rritja e vullshme fillon mes moshës 8-10 vjeç dhe arrin kulmin rreth moshës 13 vjeç. Te djemtë fillon mes moshës 10-12 vjeç dhe arrin kulmin rreth moshës 14 vjeç. Gjatë kësaj periudhe si djemtë ashtu edhe vajzat shtojnë në peshë rreth 5460 gram. Vajzat adoleshente e arrijnë gjatësinë e të rriturit rreth moshës 17 vjeç, ndërsa djemtë rreth moshës 20 vjeç.

adoleshenca mendohet si një kohë "e turbullimit dhe stresit". Edhe pse adoleshenca shoqërohet me disa probleme, ajo nuk është domosdoshmërisht një periudhë kaq stresante sa ç'është menduar në të shkuarën. Pothuajse gjithsecili në shoqërinë tonë gjatë adoleshencës ndesh në disa probleme që kanë lidhje me vetëdijen, kontrollin prindëror, kodet morale ose (përshtatjen) konformizmin ndaj normave sociale. Adoleshentët duhet gjithashtu të fillojnë të mendojnë rreth moshës së rritur, rreth asaj se kush janë ata, si dhe rreth nevojës për të marrë vendime për të ardhmen. Standardet sociale lozin një rol të madh në jetën e adoleshentit. Disa shoqëri kanë përpunuar ceremonitë e "riteve të kalimit" që mund t'u sjellin adoleshentëve statusin komplet dhe të menjëhershëm të të rriturit, si para syve të tyre ashtu edhe para shoqërisë. Shoqëri të tjera siç është shoqëria jonë i lenë adoleshentët pak a shumë të pavarur

dhe ata e arrijnë statusin e të rriturit në mënyrë graduale.

Adoleshenti i suksesshëm është ai që i përgjigjet pyetjes: "Kush jam unë?" Identiteti është një qëllim themelor në adoleshencë. Një pjesë e mirë e krizës së identitetit që përjeton rinia sot është rezultat i kërkesave kontradiktore që ushtron shoqëria mbi të. Adoleshentët janë në një periudhë kalimi midis fëmijërisë dhe moshës së rritur. Adoleshentët janë të aftë të mendojnë mirë, por nuk lejohet të marrin vendime të rëndësishme që lidhen me familjet dhe profesionet e ardhshme.

Meshkujt e formojnë identitetin e tyre si individë të veçuar, ndërsa femrat ka më shumë të ngjarë ta formojnë identitetin e tyre duke u bazuar më tepër në përgjegjësitë dhe marrëdhëniet sociale, sesa në marrëdhëniet individuale. Këto diferenca gjinore në formimin e identitetit mund të na ndihmojnë për të shpjeguar disa nga vështirësitë që kanë burrat dhe gratë gjatë bashkëveprimit.

Kur adoleshentët formojnë ndjenjën e identitetit, përpiqen shumë të fitojnë më tepër pavarësi. Reagimi i prindërve ndaj kësaj pavarësie përcakton shpesh klimën e marrëdhënive brenda familjes. Prindërit dhe adoleshentët duhet të mësojnë të përballojnë shqetësimet lidhur me komunikimin, kontrollin, pavarësinë, përgjegjësinë, autoritetin dhe stilet e bashkëveprimit. Disa konflikte brenda familjes duket se janë të paevitueshme.

Individët që kanë interesa dhe personalitete të ngjashme ka të ngjarë të bëhen shokë. Hays (1985) studioi zhvillimin e shoqërisë tek studentët dhe gjeti se me

kalimin e kohës sasia e kohës së shpenzuar së bashku dhe niveli i intimitetit të shokëve u rrit. Hays shprehu mendimin se shoqëria e meshkujve mund të zhvillohet përmes aktiviteteve të përbashkëta, ndërsa shoqëria e femrave mund të zhvillohet më tepër përmes komunikimeve verbale.

Megjithëse të gjithë adoleshentët përjetojnë probleme, disa prej tyre vuajnë nga një stres ekstrem dhe kanë probleme të rënda. Një problem serioz, i cili po rritet dukshëm është vetëvrasje në moshën e adoleshencës. Çdo vit mbi 5000 adoleshentë kryejnë vetëvrasje.

Shumë adoleshentë kryejnë vetëvrasje për arsye se ndjehen të depresuar dhe të padobishëm. Abuzimi me drogat është një problem i rrezikshëm në adoleshencë. Edhe pse alkooli dhe marijuana janë drogë më të përdorura, kokaina dhe drogat e tjera ilegale janë gjithashtu duke u përdorur. Femrat adoleshente mund të përjetojnë anoreksi nervoze, një çrregullim në të cilin një person normal e torturon veten për të ngrënë për arsye se beson se është mbi peshë. Kriminaliteti dhe krimet janë rritur po ashtu vitet e fundit. Megjithatë, siç përmendëm më sipër, shumica e individëve janë në gjendje t'i përballojnë me sukses problemet e moshës së adoleshencës dhe të rriten të shëndetshëm. Kjo varet edhe nga edukimi i tij përpara se të vij në këtë moshë.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Roza Pjetri

# KRYENGRITJA E PA DËSHIRUAR E VITIT 1911-të

Kjo kryengritje për vetë rëndësinë përmasat dhe misionin e pa përfunduar është nga ngjarjet më të shumë përshkruara dhe më të shumë kënduara të fillim i shekullit të lirisë. Një proverb universal që ishte kryefjalë edhe për Sami Frashrin thotë: “Është turp të gënjes bashkëkohësit, është krim të gënjes ata që vijnë pas nesh, prandaj shumica e historianëve janë kriminel!”.

Mendja ime, me bindje më thotë se për këtë ngjarje është orvatur më shumë se duhet, për të mbuluar disa gjera që duhen thënë shkurt dhe troç. Nga ngjarjet e mëdha dhe te vlefshme historike gjithkush do të përfitoj kapital, prandaj qoftë heshtja, qoftë tendenca revizionuese janë abuzime manipuluese për mendjet dhe shpirtrat e pasardhësve.

Konsullata austriake në Shkodër, sipas interesave të saja perandorake ka pa dhe fotografuar zhvillimet dhe protagonistet e kësaj ngjarje. Atëherë lindin pyetjet: - Çfarë u është anashkaluar pa u artikuluar si duhet njerëzve? Pse Kryengritja nuk u përhap as brenda në Shkodër, Mirditë, Pukë dhe kush e pengoj? Po Dibra perse argjiroi? Kush e nxiti dhe sponsorizoj me armë-municione dhe para këtë Kryengritje, dhe pse nuk e themi? Pse shqiptarët nuk ishin të bindur për tu ndarë njëherë e mirë nga perandoria e vjetër? Çfarë qëndrimi ka mbajtur kleri tre kolor ndaj kryengritjes dhe lëvizjes autonomiste?

Nëse është folur gjatë për shkaqet e kryengritjes duke i mshue fort faktorit të brendshëm që ishte detërmues, nga ana tjetër është folur e flitet kalimthi për rolin jashtëzakonisht të madh që pati faktori malazez. Shqiptarët e maleve ishin dashnoret e vërtetë të lirisë, por që të fillohet dhe vazhdohet një kryengritje drejt suksesit duheshin armë, municione dhe fonde financiare. Ku i morën armët, municionet dhe ushqimet kryengritësit? Pse hezitohet të thuhet se, që nga kryengritja e vitit 1910 e më pas në territorin malazez janë strehuar bujarisht ushqyer dhe armatosur qindra shqiptarë. “Konsullata e austriake në Shkodër njoftonte MPJ në Vjenë se, në Mal të zi u arratisën 100 burra të tjerë nga Shala, Shoshi e Shkreli dhe 25 familje nga Pikali (Grudë). Përpjekjet ndërmjet emigrantëve të armatosur nga Mali i Zi dhe trupave turke janë duke u shtuar (Vj 20-57, Nr 45 Shkodër dt. 25.10.1910)

Natyrisht Cetina së pari, për interesat e veta, u tregua mjaft bujare në përgatitjen, sponsorizimin, dhe mbështetje eksponentëve shqiptarë, që vinin nga shtresat e vegjëlisë (jo nga parikët e korruptuar pro otoman), si Lugj Gurakuqi, Hilë Mosi, Risto Siliqi, Dedë Gjon Luli, Mehmet Shpendi. Hasan Reçi, Muharrem Bushati e të tjerë. Interesa ndaj Shqipërisë

fatkeqësisht të vetdeklaruar si bahçe otomane, kishin të gjitha fuqitë rajonale Austria, Italia, pse jo edhe Mali i Zi dhe Serbia, të cilët të gjithë lakmonin një vend pa zot të lidhur fort pas qerres së vjetër që po thyheshin rrotat. “Ma të vështirë se Mirditë janë konditat në Pult. Këtu ka pas ekzistuar që ma parë kontakti me malazezet. Të pesë bajrakët e Pultit, Shala, Shoshi, Plani, Xhani e Kiri posedojnë tani 4000 pushke (me një fishek) dhe afërsisht 1000 mauzer. (Vj 20.6647, Nr. 178. Vjenë



DED GJO LULI

m dt.21.06.1910)

-Kryengritja e vitit 1911 fatkeqësisht nuk u shndërrua në Kryengritje të përgjithshme dhe mbeti një duet lokal Malësi e Madhe dhe Dukagjin. “Pakënaqësia tradicionale e shqiptareve, kryesisht e fiseve malore ne, në çdo gjë që është turke gjen ushqim të ri qoftë edhe te çdo gabim i vogël (Vj 21-8630, Nr. 109 Vjenë m dt.05.11.1911).

Të gjithë lajmet, që sot mbërritën këtu thonë se kryengritësit u paraqitën në masë 400 vetë Hoti, 300 Gruda, 200 nga Kastrati, 300 nga Kelmeni, 200 nga Dukagjini të gjithë te armatosur (Vj. 21-12 29, Nr. 23 Shkodër dt.11.04.1911) .... Shumë mirë të armatosur është Shala dhe Shoshi, fise të cilat kanë kontakt të përhershëm me Malin e Zi, që andej janë armatosur (Vj 21- 12 45 Nr 37 Shkodër dt.30.05. 1911).


## 1-SI U PRIT KRYENGRITJA NË SHKODËR?

Sikur në Shkodër të ziente kazani si në male ngjarjet do kishin rrjedhur krejt ndryshe, shkaku i mos përfshirjes duhet kërkuar tek zotnihanja dhe krerët fanatik të klerit mysliman, që zgjodhën anën e gabuar të historisë. Me 20 të muaj në vazhdim u nis për në Selanik delegacioni

i Sanxhakut të Durrësit, për pritje e madhërisë tij Sulltanit ai përbehet nga:

1-delegacioni i Këshillit Bashkiak (Deledije)

2- Delegacioni Xhemijetit të Shkodrës i përberë nga myslimanët Hasan efendi Bektishi, Hasan efendi Miçiç dhe katolik Vat Dashi-bajraktarë i Shkreli, i cili konsiderohet si tradhtarë banorëve të bajrakut të tij, që banon në Shkodër që kur shpërtheu kryengritja, u bind prej Turgut Pashës, të merrte pjesë në delegacion, me



MEHMET SHPENDI

qellim që në delegacionin e këtushëm të kishte edhe një malësorë katolik. Shpenzimet e udhëtimit për të i mori përsipër vetë Turgut Pasha. (Vj 21- 9/981.Nr 32 Shkodër dt.26.05. 1911).

Paria e Shkodrës e shqetësuar në kulm nga hovi i kryengritjes, me propozim të Guvernatori të përgjithshëm nga Stambolli u filluan sot me shpërndarjen e pushkëve nga depot armëve të këtushme... Edhe në fshatrat muhamedane të rrethinave u dërguan dje hoxhë të ftojnë popullatën e tyre të shkojnë në Shkodër të armatosur... Kleri, institutet fetare dhe katoliket e pa mbrojtur e shohin vetën të kërcënuar në sigurinë e tyre. (Vj 21-12.29. Nr 23 Shkodër dt.11.04 1911).

Historia kur flet me gjuhën e së vërtetës, është mësuesja më madhe. Nuk duhet të flitet vetëm me epitetet metaforike për protagonistët e kësaj lëvizje, që lulëzuan token me lule gjaku arbëror dhe të heshtet ndaj atyre që u rreshtuan në anën më të shëmtuar të historisë.

Paria dhe krerët fanatik shkodrane në një telegram dërguar Stambollit shprehej kundra koncesioneve për malësoret...”*Me përjashtim të një pjese të malësorëve rebel, mbetje e popullores malësore gënjer nga propaganda e huaj ...Gjithë popullata e brendësisë së këtij Vilajeti, kanë vendo-*

*sur të jenë besnik të qeverisë konstitucionale otomane... Publikojmë se besa tonë u përqendrua prej shumë kohësh të bashkohemi si bashkëqytetarë të mirë të gjithë jemi gati të vdesim e shpëtojmë nga duart e fëlliqura, që po përgatiten të mbledhin këtë përçarje... Si shqiptarë otoman, të lindur siç jemi otoman duam të vdesim! Nuk ka njeri që do sakrifikojë vullnetarisht jetën për perandorinë osmane. Rroftë Perandoria Osmane, mallkue qofshin separatistët!*

*Në emër popullsisë së Shkodrës Myftiu, me 30 vula personale të mirënjohura”. (Vj 21- 12 558 Nr 49 Shkodër dt.13.07. 1911).*

Krejt ndrysh ishte tabloja në Malësinë e Madhe, ku katolik dhe mysliman luftonin krahas krahas për lirinë që po lindte nga parzmat e maleve.

## QËNDRIM I KLERIT KATOLIK ITALISË DHE AUSTRISË

Kleri katolik, për vetë pozitën në të cilën ndodhej, nuk e kishte të lehtë të rrëmbente flamurin, por është për të ardhur keq, që për sanguizmin dhe qëndrime burracake që manifestoi.

“Në rastin e shpërthimit të kryengritjes, kleri katolik u ndodh deri në një farë pike të vështirë, pasi nga ana e shqiptareve nacionalist ju ba akuza se, me anën e ndihmave që ishin dhënë vitin e kaluar komisionit të çarmatimit, ai paskësh bërë dëm të madh çështjes kombëtare. Më gjithë këtë hije delikate Imzot Serreqi, diti të mbante një qëndrim të matur”. (Vj 21- 4/ 410Nr 202/2 Shkodër dt.05.05. 1911).

Austria mbështetësja dhe mbrojtësja Klerit të lartë Katolik, për momentin ishte kundër lëvizjeve patriotike që mund të sillnin ndryshime në Ballkan, prandaj në bashkëpunim me klerin ka ushtruar trysnin e vet në mospërhapjen dhe fikjen e kësaj kryengritje. Në Itali, Shtypi përparimtarë republikan i beri jehonë të madhe Lëvizjes malësore, madje filloi mbledhja e vullnetareve të armatosur, por që u penguan nga forcat qeveritare. Çështja shqiptare u përkrah veçanërisht nga kolonitë arbëreshe, që zhvilluan një veprimtari të gjerë në të mirë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Edhe mjaft të rinj italianë e të vendeve të tjera, studentë e punëtorë, shprehën gatishmërinë për të marrë pjesë në ekspeditën e vullnetarëve, të cilën mendohej se do ta drejtonte i biri i Xhuzepe Garibaldit, Riçioti Garibaldi (Ricciotti Garibaldi).

Atdhetarët shqiptarë punonin për të siguruar përkrahjen e qeverisë italiane. Por qarqet qeveritare italiane mbajtën një qëndrim tjetër nga ai i popullit italian. Italia po përgatitej atëherë për luftën për të pushtuar Tripo-

# Promovimi i librit “SHTIGJET E PËRGJAKURA”

Me datën 10 prill 2021, në “Grand hotel Evropa”, në Shkodër, u bë paraqitja e librit, me titull “Shtigjet e përgjakura”, të autorit Ali Daci, nga Rrozhaja.

ALI DACI, publicist, analist, studiues, veprimtar politik e shoqëror, nga Rrozhaja në Malin e Zi; Drejtor i Manifestimit Tradicional Kulturor Mbare Shqiptare “Ora e Maleve” në Rrozhajë; Nënkyetar i Shoqatës Kombëtare “Kosova për Sanxhakun”; “Qytetar Nderi” i Pejës në Kosovë; nënkryetar i të pares parti shqiptare-LDSH në Malin e Zi; I dekoruar nga Presidenti i Shqipërisë, zoti Ilir Meta me Urdhrin e lartë “Naim Frashëri të Artë”; autor me libra poetik, studimor e publicistik si monografia “Shtigjet e Përgjakura”, vëllim me poezi “Shtigjeve të rinisë”, e të tjera, nderuar me disa çmime (ndër)kombëtare, “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini” dhëne nga Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, dhe sikurse me rastin e 7 Marsit - Ditës së Mësuesit, me Çmimin e lartë “Pena Alpine”- nga “Gazeta e Alpeve”.

ALI DACI, sot ndodhet në Spitalin e Pejës, me probleme serioze të shëndetit, prandaj nuk mundi të jetë i pranishëm. Kishin ardhur miqtë dhe koleget e tij nga Kosova. Kryetari i Organizatës Kosove për Sanxhakun z. Ismet Azizi; Sekretari i Klubit Letrar “Podguri”, z. Nuredin Imeraj, me qendër në komunën e Istogut; Kryeredaktor i gazetës të “Alpeve”, z. Ramiz Lushaj;


Nga Shoqata Atdhetare “Malësia”, kryetari i saj z. Ilmi Kurti, ishte mikpritësi dhe organizatori.

Falë bujarësi të “Grand Hotel Evropa”, me pronar z Agron Çela, ishim vërtet në kushte komode. Respekt mediave lokale që e përcollën këtë veprimtar të veçantë dhe emocionues, të paraqitjes të këtij libri, me vlera të veçanta për edukimin e

brezit të ri.

E hapi këtë paraqitje libri, gazetarja dhe moderatorja e njohur zj. Linda Doda Kavaja, e cila uroj mirëseardhjen publicistit dhe historianit z. Ilmi Kurti.

Rreth librit referuan z. Ismet Azizi,



profesori Nuredin Imeraj, poeti dhe historiani Prel Milani. Përshëndetën, Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, z. Ndue Sanaj; Poetja Farida Ramadani; veprimtarja dhe organizatorja e suksesshme e Logut të Bjeshkës”, znj. Dila Vaçaj; Etnografi emblematik z. Shtjefen Ivezaj; kryeredaktori i gazetës se “Alpeve”, z. Ramiz Lushaj; sportisti i njohur i peshëngritjes z. Faruk Kalleshi dhe shumë të tjerë të pranishëm.

Pata privilegjin të përcjellë për të pranishmit fjalën përshëndetëse të z Ali Daci por edhe të mundësoj atij ndjekjen direkt te aktivitetit

Emocione të papërshkrueshme!

Faleminderit secilit që vlerësoj punën dhe librin e mikut tone, z. Ali Daci.

Shërim të shpejte dhe çdo të mire për ty miku im i nderuar, Ali Daci!

**Përgatiti Lulash Brigja,  
Shkodër, më 10. 04 .2021**

lin. Në këto rrethana Roma nuk ishte e interesuar të ndërhynte në Shqipëri, sepse kjo do të shkaktohte kundërveprimin e rivales së saj, të Austro-Hungarisë. Në shkurt të vitit 1911 qeveria italiane e ndaloi ekspeditën e vullnetarëve dhe mori masa për të penguar çdo ndihmë, që mund t'u jepej kryengritësve shqiptarë nga Italia.

Austria kishte frikë rritjen e një ndikimi italian në Shqipëri, prandaj ka luajtur rolin e zjarrfikësit së bashku me klerin katolik. Konsulli austriak në Shkodër Zambaur njoftonte Vjenën në lidhje me takimin që kishte bërë me Shefqet Turgut Pashën, të cilit i theksova përpjekjet e klerit katolik qysh në Kryengritjen e Kosovës me i përmbajt malësoret që të mos merrnin hapa të pa matura”. (Vj 20- 4/ 405 Nr 62 Shkodër dt.27.07. 1911) .... “Puna e Imzot Doçit e bërë në këtë mënyrë konsiderohet në interes të frenimit të lëvizjes Kryengritëse me vërtetë si jashtëzakonisht e dobishme (Arkivi Konsullatës Vjenës po aty fq. 238). Sipas hierarkisë qëndrimit e prelatëve të lartë ishin të detyruar për bazën e gjerë të klerikëve, ndonëse një pjesë e tyre sidomos në zonat ku valonte lëvizja ishte përkrah besimtarëve të tyre që i bëzanin lirisë. Madje ata zhvilluan edhe një mbledhje dhe me anën e disa letrave kolektive kërkoni që të influen-

conin qëndrimin e tyre ndaj Arkipeshkvit Imzot Serreqit, por nuk ja arritën... Imzot Serreqi i shqyrtoi me qetësi dhe i zoriti në masë të drejtë”. (Arkivi Konsullatës Vjenës po aty fq. 238). Konsulli Vjenëz i kënaqur në qëndrimet pacifiste frenuese të Imzot Serreqit njoftonte eporet e vet për një shqetësim të ndonjë “rebeli” si Dom Luigj Bumçi, Dom Andre Mjeda, i cili ishte prezent në një takim të thirrur nga Arkipeshkvi për qetësimin vartësve “rebel”. “Mas një debati të shkurtër dhe ndrysh sa pritej Imzot Mjeda iu bashkua qëndrimit të arkipeshkvit të këtushëm”. (Arkivi Konsullatës Vjenës po aty fq 238)

## QËNDRIMI PUKËS DHE MIRDITËS JASHTË KRYENGRITJES

Mos pjesëmarrja e këtyre dy trevave qe një dem i madh frenues për shtrirjen e Kryengritjes në pjesën dërmuese të veriut. Ky qëndrim frenues ka të bëjë direkt me misionin pacifist të Imzot Prek Doçit. “Në Mirditë para dy javëve shkoj kryeabati Imzot Doçi, i cili në kuptim të instruksioneve të marra nga autoritetet e vilajeti e nga kjo zyrë pa u lodhur synoj të ndalonte popullin që të mos merrte veprimet e përmendura nga organet qeveritare”. (Vj 21- 12 65. Nr Shkodër dt.17.07. 1911). Në ngjirjen akull të ujëvarës Mir-

ditor rol të dorës pare ka luajti edhe dyzimi i Prengë Pashës. “Qëndrimi i Preng Pashës s'ka qenë kurrë i qëndrueshëm dhe në tilla raste do behët akoma më i pa qëndrueshëm.” (Arkivi Konsullatës Vjenës po aty fq 383).

Korrespondenca e Vjenës me konsullatën e saj në Shkodër, është një arkifakt që dëshmon qartë se feja dhe atdheu nuk kanë qenë kurrë në një peshorë as për klerin katolik, që është më progresivi nder tre kastat tona klerikale në lidhje me atdheun. “Nga raporti juaj del se kleri i latë i atjeshëm dhe i ultë me përjashtime shumë të radha, morën anën tuaj në përpjekjet tuaja me ndalues shqiptarët katolik të mos marrin hapa të pa matura dhe se me rastin e bisedimit tuaj me Shefqet Turgut Pashën. Ky qëndrim paqësorë i klerit është çmues plotësisht edhe prej tij”. (Vj 20- 451 Nr 2341 Vjenë dt.19.08. 1911). Në kohën kur rojtaret më të zjarrtë të traditave, kanunit, lirisë dhe besimit 2000 vjeçar kishin nxjerrë nga zemra shkëmb flamurin e Kastriotit dhe luftonin plot sakrificë dhe flijoheshin nën hije të tij. Ndërkohë saingunizmi, cicmicet dhe frenatot e klerit katolik, ishin bisht dredhje, që nuk i bëjnë aspak nderë asaj elite, që në fushën e kulturës kishte qenë pararojë shekullare.

Kryengritja malësore e vitit 1911 për-

fundoj me një marrëveshje gjysmake për shkak se nuk arriti të shndërrohej në një kryengritje të përgjithshme. Ajo nuk arriti ta detyronte qeverinë xhonturke të pranonte kërkesat autonomiste të Memorandumit të Greçës.

Kryengritja tregoi se shqiptaret më të vonuarit e Ballkanit akoma nuk ishin në gjendje të mendonin, as të vepronin të bashkuar si zot i fateve të veta. Gjithsesi orteku i krismave të pushkëve të tua Malësi, ishte ulërime e madhe e pavarësisë gjysmake, që ne, na dhuruan, ishte marrshi luftarak kombëtarë, trokitja dhe zgjimi i detyruar i Fuqive të Mëdha, të cilat o me hir, o me pahir, pranuan më në fund se ka një Shqipëri.

Heronjtë e atdheut janë pigmenti i ngjyrës së flamurit, palca e shqiptarizmit, mushti jetësor i kombit, hareja e zemrave të ushqyera me dashuri dhe flaka e vllaznimit kombëtar.

Mirënjohje dhe lavdi të përjetshme dëshmoreve të Kryengritjes lapidare të Malësisë së Madhe, e cila rrezaton në histori si yll i mëngjesit të pavarësimi!

Asnjë trashëgim nuk është më kushtueshëm si therorizimi i juaj madhështore!

**PRELË MILANI**

# GJON DUKGILAJ, Mjeshtër i Madh!

**BASHKËBISEDIM ME PRONARIN E BAR-RESTORANT-HOTEL “TRADITA-GEGE&TOSKE”-**

*Biznesmeni, pronari i Bar-Restaurant-Hotel “TRADITA”, Gjon Dukgilaj, me propozim të Presidentit të Shoqatës së Restoranteve të Shqipërisë, zoti Kujtim Dervishi, me datën 7 prill 2021, në Presidencë i jepet dekorata e larte “Mjeshtër i Madh”, nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Ilir Meta, me motivacion: “Për arritjet e tij të suksesshme në fushën e kulinarisë, turizmit etnokulturor dhe agroturizmit në trevën e Shkodrës. Me aftësi të larta administruese në harmonizimin e artit të gatimit për ruajtjen e vazhdimin e trashëgimisë sonë të pasur etnografike, kostumeve autentike dhe banesës karakteristike shqiptare”. Me këtë dekorim “Mjeshtër i Madh”, u vlerësua puna e palodhur e dy dekadave të këtij dukagjinasi të palodhur për të shpalosur në çdo kohe vlerat dukagjinase. Një kënaqësi e veçantë jo vetëm për zotën Gjon, për familjen e tij, për Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, e bashkësinë dukagjinase kudo jeton, por dhe për bashkësinë shkodrane! Prandaj i urojme: “Ta gazojë dekoratën, me faqe të bardhe në punën e tij, në punën për të realizuar misionin e tij.*

Me këtë rast, me zotën Gjon Dukgilaj, po bëjmë këtë bashkëbisedim:

**Kush është Gjon Dukgilaj? Çfarë ju lidh me Dukagjinin?**

Unë kam lindur në krahinën e Shalës, ne fshatin Lotaj. Jam biri i Martin Gjon Gilaj dhe i Nënës time të shtrenjte Age Qerim Gilaj. Kam mbaruar shkollën 8 vjeçare në Breg-Lumi, në një bashkësi të avancuar dhe e emancipuar për kohën, jam rritur në një mjedis familjare shumë patriot dhe mes bukurive dhe krijesave natyrale plot frymëzim. Jam vëllai i 6 motrave dhe 3 vëllezërve dhe të gjithë kemi nga pak art në dejtë tonë si shumë malësoreve të tjerë.

Në moshën 14 vjeçare largohem nga Shala fizikisht, për të vijuar shkollën e mesme dhe më pas studimet universitare në Shkodër.

**Si lindi biznesi i juaj, fale një sponzaniteti apo produkt i një ëndrrë dhe një pune të vazhdueshme?**

Tre janë gjerat që me frymëzuan ti futem botes së biznesit: Së pari, EDUKATA, që Nena na kishte dhënë për punën. Së dyti, DËSHIRA për të bërë diçka për vendin tim. Së treti, KONTAKTI dhe PUNA në Evropë.

**Që kur e keni filluar biznesin tuaj?**

Biznesin e kam filluar në 2002. Fillimisht me një karburant e lubrifikante të ndryshme po sa isha kthyer nga emigrimi, ku kisha qëndruar e punuar për disa vite me radhe. Në këtë kohë fillova restaurimin e Shtëpisë, e cila ishte me plot histori nga lindja e Filip Shirokës e deri tek përcjellja e fundit që i bëme babës tone dhe duke ruajtur e pasuruar shumë elemente arkitektonik të saj.



**Pse e keni pagëzuar me emrin “TRADITA”, madje “Gege&Toske”?**

Duke pasur parasysh një shtëpi kaq madhështore në një pozicion të përshatshëm për të bërë biznes dhe duke ruajtur traditat si nga Veriu ashtu dhe nga Jugu në Gastronomi dhe Etnografi, ky do ishte emri më i goditur dhe më rrezistent ndaj kohës.

**Ky biznes i juaj, çfarë përfshinë?**

Biznesi ynë bazohet në 4 komponentë: Etnografi, Fotografi, Gastronomi dhe Arkitektura.

**Gjon Dukgilaj, biznesin e tij, nuk e ka ngushtuar brenda vetvetes, por e ka shtrirë dhe në fusha të tjera, në shërbim të bashkësisë dukagjinase. Ka**

**mundësi të rrëfehëni para lexuesve të gazetës “Dukagjini”?**

Ambicimet e mija për vendlindjen janë një ëndërr e përhershme që lus Zotin të bëhen realitet. Projektet janë ambicioze dhe në shërbim të bashkësisë sonë. Unë dhe ju do të shohim shumë shpejt një lulëzim të turizmit në 11 muaj dhe jo me 3 muaj sezon. Bashkëpunimi im me bizneset e tjera qoftë në Theth, Lumi i Kirit apo Lumi i Shalës ka për të qene i pa ndërprerë. Njëkohësisht, rekomandimet e mija të sinqerta nuk ju kane munguar, dhe tani po shikojmë të shtrihemi në krahinën e Shalës, të Shoshit, të Pultit dhe në Qafë Thanë.

**Gjon Dukgilaj, në mjaft raste është treguar human në shërbim të çdo gjeje,**

që ka të bëjë me emrin Dukagjini. Ju mundësuat financiarisht përgatitjen e vendosjen e memorialit të Edith Durham, në krye të fshatit Theth, nga shikohet e gjithë lugina e Shalës; botimin e gazetës “Dukagjini”; ndërtimin e vendosjen e monumentit të atdhetarit Mehmet (Sokol) Shpendi dhe të albanologut Martin Camaj, dhe në fusha të tjera. Çfarë ju shtynë për të dhënë gjithë këtë kontribut?

Të gjitha këto që ju përmendet më japin shumë kënaqësi, por jo vetëm kaq, ne kemi prezantuar Shqipërinë para disa vitesh në Spanjë me një grup të gjithë të veshur me rroba tradicionale- kombëtare nga Dukagjini, ku bëme prezantimin e gastronomisë dhe etnografisë Shqiptare. Me kostumin tone isha para 3 vitesh në Parlamentin e Britanisë së Madhe dhe të nesërmen, në dhomën e tregtisë së Londrës prezantova burimet dhe pasuritë e Veriut në turizëm. Para 6 vitesh, në vitin 2015 prezantuam Shqipërinë në gastronomi në të gjitha vendet e Mesdheut, në një paraqitje të organizuar në brigjet e Egjeut. Dhe në vitin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut ishim të vetmit në Shkodër që bëmë pritjen e grupit të Arbëresheve të shoqëruar nga stërnipi i Gjergj Kastriotit dhe përmes një spektakli që organizuam në ambientet e “Tradita- Gege & Toske” për nder të tyre, gërshtuam më së miri muzikën e folklorit dhe gastronominë mes nesh. Dhe me rastin e 550 vjetorit të Vdekjes së Prijësit tone Kombëtar, Gjergj Kastriotit- Skënderbeu, ne u kthyem në institucion, duke bashkëpunuar me TV “Top- Channel”, për të rikthyer ritin e moçëm të Shqiptareve, që tashme mbijeton vetëm në malet tona, “Gjamen e Burrave”, një realizim i përsosur fale dhe burrave të Dukagjinit, e cila mori vlera në përmasa historike. Edhe para pak ditëve realizuam një tjetër “Gjame e Burrave”, për të pare vlerat brenda saj të shprehura në art.

Kemi lobuar fort për rrugën e Dukagjinit dhe për shtigje të reja. Prej më shume se dy muaj po llojme gjithashtu për rrugën Shkodër-Prekal-Guri Kuq-Vuksanaj-Nikaj Mertur-Gjakovë, që një turist të rrije 15 dite në Alpe, që Shkodra të kthehet në një qendër Universitare





Tregtare Spitalore e Turistike të dëshiruara.

**Me gjithë këtë punë dhe hapësirë, që keni hapur me biznesin tuaj, sa punonjës përfshinë biznesi i Juaj? Sa janë të siguruar?**

Sigurisht kjo hapje e biznesit tone, kërkon edhe punëtor, në veçanti specialiste, që duan mbi të gjitha artin. Prandaj, zakonisht ne, kemi nga 18 deri në 35 vete të punësuar në biznesin tonë, që varet nga sezoni turistik. Të gjithë punonjësit janë të siguruar në baze të ligjeve të shtetit tonë.

**Ligjet e qeverive të këtyre 29-30 viteve a kanë qene stimulues për biznesin tuaj apo ndonjëherë e kanë goditur atë?**

Sektori I turizmit është i ri dhe i pa njohur sa duhet në vendin tone dhe për këtë lloj biznesi, ligjet sapo kanë filluar. Por për objektet e rëndësishme së veçante jemi shume larg, për të specifikuar ligje të veçanta, të cilat të nxisin apo stimulojnë ruajtjen e objekteve të veçanta, gjë të cilën bota e ka në prioritet.

**Ju, jeni dukagjinas. A ka ndikuar biznesi i Juaj në zbutjen e varfërisë së familjeve të zbritura nga Dukagjini në këto vite të fundit?**

Patjetër që po. Unë jam munduar ta zmbars varfërinë me diturinë, e cila është dhe vlera më e madhe për të ardhmen.

**Nder kushtet themelore për pranimin e Shqipërisë në B. E, është ekonomia e lirë e tregut. Sa është i përmbushur ky kusht, sipas jush në Shqipëri?**

Fatkeqësisht, ne jemi shume larg saj! Ne, në radhe të pare, duhet të përmirësojmë edukimin, edukimin dhe edukimin. E përsërita tre here, se ne duhet të jemi të edukuar, jemi larg kërkesave të kohës për gjithçka, por në veçanti për të pritur turistet. Mënyra e komunikimit, është fillesa e takimit me të huajt, të cilët që në atë moment, që aty krijojnë mendimin për të ecur apo jo. Të tjerat vijnë automatikisht.

Shteti dhe biznesi duhet të gjeje mënyrat për të rritur pagat dhe pensionet. Pastaj, pas 20 vitesh BE-ja vjen vete.

**Në qoftë se pranë biznesit Tuaj apo në të njëjtin rajon dhe më gjere, ngrihet një apo ngrihen biznese në të njëjtën linje, cili do të ishte veprimi i Juaj i pare për t'i mbijetuar konkurrencës?**

Në Shqipëri e rajon nuk kemi konkurrenues, ne dhe konkurrentet duhet të punojmë së bashku që të thithim sa më shume vizitore. Konkurrenca e mirë, e ndershme e rrite destinacionin dhe suksesin.

Çfarë duhet të bëjë një biznesmen në rast se e ndjenë "rrëqethjen e falimentimit", të cilën nuk ua dëshirojmë kurrë?

Në kapitalizëm falimentimi është i pranueshëm. Vete sistemi është një gare me përvojë. Pra, duhet të ngrihesh dhe të vijosh garën përsëri aty apo në një fushë tjetër.

**Dramaturgu i madh anglez, Shekspiri ka thënë: "Në shoqërinë kapitaliste i vetmi motiv që lëviz shoqërinë është paraja". A e besoni ju dhe aktualisht a ka motive të tjera në shoqërinë e sotme shqiptare?**

Nuk mendoj krejt ashtu edhe pse paraja



është një faktor, por për njerëzit me energji pozitive edhe pa para gjerat mund të ecin përpara.

**Në regjistrin e fjalorit të thjeshte biznesmenin e quajnë jo human, madje edhe deri aty sa ta quajnë "shfrytëzues". Nëse detyroheshit të përgjigjeshit ndaj kësaj "akuze", cila do të ishte përgjigja Juaj?**

Ne mendohe mi disiplinujmë, ti edukojmë, ti trajnojmë punëtorët me të cilët punojmë dhe duke i kthyer në specialistë do të kenë një patente, e cila do ti ndjeke

nga pas kudo që të shkojnë. Ne shquhemi për tolerancën, buzëqeshjen e mirëkuptimin dhe le t'ia lemë ditës së gjykimit, se shpesh shkojnë në ferr dhe ata që janë lute gjithë jetën! Mos të harrojmë, që ne u rritem në një familje të madhe, edukata e së cilës do të na shoqëroje gjithë jetën me ndjenja e norma njerëzore..

**Cili do të ishte mesazhi që do t'i përcillnit bashkësisë dukagjinase në veçanti dhe gjithë bashkësisë shkodrane në përgjithësi?**

Dukagjini nga analizat gjenetike është



gjaku më i vjetër në Ballkan dhe sipas një studiuesi Gjerman ata që u shtynë drejt maleve, ata janë më të vjetrit, ata ruajtën gjuhën e traditat. Dukagjini sivjet prezanton Xhubletën në UNESCO dhe në vitet në e vijim do te prezantoi "Gjamen e Burrave", "Vajnicen e Drujt", por nuk është e mjaftueshme. Shkolla dhe edukimi, disiplina dhe puna do të sjellin gjallërinë, në kohen dhe vendin e duhur. Fjala Shkodër ndahet në Skut-ari dhe ne historikisht jemi pjese e saj.

**Krijimin e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" si e keni pritur dhe çfarë mund të thoni për të dhe gazetën e saj "Dukagjini"?**

Puna juaj e palodhshme dhe energjia juaj si grup është për tu lavdëruar. Pra, kështu si e thashë më sipër nuk është paraja grithsha! Unë ju përgëzoj!

**Shoqata Atdhetare "Dukagjini", prej kohesh ka shtruar krijimin e "Klubit" me biznesmen e tregtare dukagjinase, ose me prejardhje nga Dukagjini, nëpërmjet së cilit do të sigurohej mbështetja financiare e Shoqatës për realizimin e misionit të saj. Gjithashtu të krijohet Kompania "Dukagjini", e cila të jete mundësori dhe ndërtuesi më i madh, për nevojat e Dukagjinit. Ju ftojme të bëheni pjese e këtij "Klubi" apo e kësaj Kompanie. Mendimi i juaj?**

Unë e uroj me shpirt këtë iniciativë dhe dua me shpirt që të krijohet. Në vitin 2001-2002, me një grup bëmë shume përpjekje për të themeluar një grup të tille, por asnjëherë nuk është vonë. Jam shume dashamires dhe pse aderoj në klube të tjera, ta ndajmë eksperiencën me ju.

**Ju uroj faqebardhe për dekorimin tuaj e të biznesit tuaj, me dekoratën e larte "Mjeshtër i Madh"! Gjon Dukgilaj si e ndjen veten?**

Njerëzit ndahen në punëtorë dhe në dembel, në të mirë dhe jo të mirë. Ata, që duan punën dhe mendojnë pozitivisht e marrin gjithmonë shpërblimin, i cili mua më bën më të fortë për të vijuar rrugën tonë në mbrojtje të vlerave kombëtare.

Gëzimin e këtij titulli e ndaj me familjen, me bashkëshorten time, Raimonden, që e kam krahe të djathte e të majte. Gjithashtu e ndaj dhe me personelin, me të cilët bashkëpunoj. Tashmë dihet, që prej kohesh tradita është një destinacion, ku shprehja "Shtëpia e Zotit dhe e mikut", është çdo dite prezent.

**Bashkëbiseduesi:** I nderuar Gjon, këto pyetje mendova t'ju drejtoj, që juve të bashkëbisedoni me lexuesit e gazetës "Dukagjini". Ju falënderoj për përgjigjet dhe kohën që na kushtuat për këtë bashkëbisedim. Gjithashtu ju urojme, me faqe te bardhe dekoratën e larte "Mjeshtër i Madh", e cila me siguri do t'ju shërbej për të të nxitur e shkuar më tej në realizimin e misionit tuaj!

**Gjoni Dukgilaj:** Ju faleminderit juve, e me dhatë mundësinë të bisedoj me lexuesin e gazetës së dashur, e pagëzuar "Dukagjini"!

Mirënjohje për punën që bëni!

**Bashkëbiseduesi,**  
**Ndue Sanaj,**  
**Shkodër, me 19 prill 2021**

# ZEF MALA, PËR GJERGJ FISHTEN DHE GJUHËN SHQIPE (VITI 1955)

Unë, Zef Mala, kam manifestue dhe kam qenë kundër faktit që një poet i madh si Fishta të braktiset në një anë vetëm për shkak të ideve të tij. Unë mendoj se përgjithësisht në letërsi dhe në art më shumë se personaliteti i artistit, ka rëndësi vepra e tij.

- Fishtën unë e konsideroj si poetin më të mirë të gjuhës shqipe që i ka kapërcyer kufitë e Shqipnisë dhe të Ballkanit dhe zë vënd midis poetëve më të mëdhenj evropianë të shekullit tonë. Do të vijë një kohë që Fishta do të rehabilitohet (viti 1955)

- Unë në artin kërkoj më tepër formën në të cilën është paraqitur se sa përmbajtjen. Për mua përmbajtja është në radhë të dytë.

- Kam manifestue e kam shfaq mendim se gjuha letrare e ardhshme duhet të hartohet mbi gegënishten.

- Kam qenë i mendimit se, për sa i përket shkollave të fillores dhe unikes, të jepeshin mësim në dy tekste, gegënisht për shkollat e veriut, dhe toskërisht për shkollat e jugut. Jam i mendimit se tendenca e zhvillimit të gjuhës shqipe shkon drejt gegënishtes. Instituti i Shkencave ishte drejt zhvillimit të gjuhës toskërisht. Vetë fakti se kryeqyteti është në Tiranë, do të krijojë mundësinë e asimilimit të gjuhëve shqipe dhe ka për të prodhuar dialekti gegënisht i Shqipërisë së Mesme.

Tash për tash, mendoj se duhet të ketë dy abetare, gegënisht e toskërisht.

Për shkollat e nalta kam mendimin se duhen drejtuar nga kuadro e specialistë të huaj, si nga B. S e vendet e Demokracisë Popullore, me afate të gjata 10-15 vjetësh dhe pranë këtyre të qëndrojnë profesorët dhe studentat më të mirë, për ndryshe, asht rrezik që arsimit ynë të bjerë. Prandaj detyra jonë duhet të jetë jo zgjerimi i shkollave të nalta, por ato të jenë pak por saktë.

Për mendimin tim, niveli i studentave që mbarojnë jashtë, në vendet e Demokracisë Popullore është më i lartë se niveli i studentave që mbarojnë në institutet tona.

## Kristalizimi i ideologjisë shqiptare

Në "njeriun" të shofim Zotin, të shofim kultin tonë e mitin e përzemërt.

Jemi shtegtarë që nisemi prej etapës që rrin fort larg me cakun, ku kanë mbërritë popujt e tjerë perëndimorë.

Ne duhet domosdo me ia mbërritë atyne, edhe pse ata kanë kalue shumë etapa. Janë vetë konditat jetësore që do të na shtyjnë për kah ai afrim. Ne nuk do të shkojmë tue u përligjë nëse mendojmë nëse jemi të rinj. Epiteti justifikues "i ri" për ne s' do të jetë tjetër veç se një shkëndi që do ta mbajnë pranë për një flakë entuziazmi ndër fushat e veprimit tonë e ndër sferat

Nga Zef Mala\*

tona idealistike e morale. Njeriu që shkon tue intensifikue veprimet e aktet e veta nësa mendon se asht i ri, ai s'ka me ja dalë kurrfarë qëllimit që do t'i vejë vetes. Ai, edhe pse burrë, asht fëmi. Për ata kishte me qenë shumë ma mirë me thanë: Kam qenë, jam e kam me vdekë fëmi. Ndryshe s'ka.

Në bazë të një ligji fizik në një trup, që qëndron po në një pikë, s'ka lëvizje. Tue ju përshatë njeriut t'atille, do të themi se s'ka jetue. Qe i vdekun e mbetet i vdekun.

Porse ne si apiratorë të një jete të paravuemë, do të jemi plot energji e dinamizëm. Vdekja për ne do të jetë personifikimi i anmikut që do ta përballojmë e që do ta luftojmë. Këtë gja do ta rranjosim e do ta gdhendim kaq fort në zemër e në shpirtin tonë, sa do të jemi të bindun me fanatizmin ma të madh të një fetari, se këtu rrin misioni i ynë që na asht dhanë e që ne me falenderjen ma të madhe e kemi përfaque.

Neve, tashti në bazë të një fjale Shqipëtare që thotë se trimi i mirë me shokë shumë, pikësëpari na mbetet me kontrollue vetveten. Do të hedhim një shikim të thellë përsa na rrethon. Do t'i njofim mirë shokët tanë shtegtarë për kah i njejtë qëllim. Të vërejmë se mos jemi gabue në sistemet tona ideologjike. Të paravejmë planin tonë veprimtar të të gjithëve për me munde kështu me e studjue e me e kthjellue. Do të kemi kujdes të madh mos na shkojë huq gjithçka. Po nuk patëm ra në godi, asht kot që t'i hidheni luftës, asht utopi që të kërkojmë të kapemi kah një ideal i përbashkët. Mos të kemi ambicien e një ego kryesie kah fushata e ideologjisë shqiptare. Duhet po që të kemi auto kryesi n'ideologjinë tonë shqiptare, por të mbahet një kondensim totalitar. Për ndryshe ne s'kena me qenë kurrë të zotët me hedhë ma të voglin hap kah përparimi e drita e kulturës. Kemi me mbetë të hutuem pada e gjithmonë në veprimin tonë. Asht e nevojshme pra që prizmi i kristaltë i ideologjisë sonë të vetpasqyrojë të gjithë neve. Të bajmë që të hedhi shkëlqimin e tij me rreze të barabarta në çdo anë të lamës sonë jetësore. E për me ardhë këtu duhet që së parit të shkrihem në flakën e zjarrtë të dashunisë. Të shkrihem për me mundë kështu të hyjmë në këllëfin ideal të njeriut.

Atëherë kemi me ditë e me kuptue gjithçka. "Me dashtë asht me kuptue!" Kështu pat thanë Apostulli i pasivitetit dhe eprori i njerëzimit. Jo m'u lidhë brenda zinxhirëve të arsyes së thatë, prej kah mandej nxitemi prej ambicieve të egoizmit. Due sepse due, jo due sepse mënj. Jo, se atëherë kollajsisht munden me u fikë xixat bujare të asaj flake shpirtnore. Dy forca të barbarta të kundërvume s' rezultojnë



Zef Mala, Drejtor i parë i Arkivit të Shtetit, 1949-1952


gja. Mbërrimë në apati ose në mizantropi që na ulë nga radha e shoqnisë njerëzore. Në "njeriun" të shofim Zotin, të shofim kultin tonë e mitin e përzemërt. Aty kemi me i gjetë të gjithë gurrat e kullueta të asaj jete të andërrueme. Në "Njeriun" po, e aty vetëm mundemi me gjetë amshimin. Ai asht misteri përpara të cilit do të gjunjëzohemi me nderimin ma të madh. Për gjithçka mund të dyshojmë, por vetëm për shoqërinë njerëzore, jo, jo, jo; sepse dashunija e saj na ep shkasim e hapave nga horizontet e pastra të idealit. Ajo në krahnorin e vet na premtion lëmimet, gëzimet e përkëdheljet e ambla. Na ep zjarrin hyjnor, në të cilin fikim çdo mëni e ndjesi të ulët. Prej gjithë të saj ne të presim qumështin që do të na mbajë gjallë me jetë, me ideal e me dashuni. Ajo dashuninë e vet ta falë menjherë mjaft që t'ia falësh edhe ti asaj.

Për me dashtë atë të mendojmë se na do edhe ajo neve. Shifni me sa pak sakrificë mundemi me ia dalë qëllimit që kërkojmë të arrijmë. Zemra, vetëm zemra, ban vepra të mëdha. Shpesh herë arsyeja ndalë guximim. E përkundra zemra kapërcen çdo pengim që mundt të qesë mendja. Vetëm guxim pra lypet e këtë do ta kemi prej shpirtit. Ka thënë Unamunoja se nuk asht mendja që bani të vërteta në jetë, por guximi i atij burri që trumbeton sheshit. Po kërkuem Zotin e gjejmë në "Njerëzinë", por kërkuem idealin e gjejmë në "Dashuninë". Tashti vjen pyetja po si kemi me dashtë shoqinë njerëzore po nuk deshëm rrethin e familjes sonë. Pra të kërkojmë me dashtë atdheun tonë, të bukurën Shqipni e frymëzimi i kësaj Zoje të shenjtë ka me na ba dashunorë për mbarë njerëzimin e për mbarë botën. Të heqëm paragjykimet, ambiciet e egoizmat

që na kufizojnë. Të kapemi për kah një ideal që të përfshijë vllazninë tonë pa ndryshim feje. Të gjithë jemi vëllezën pse përpara se me qenë muhamedanë, katolikë, ortodoksë, kemi qenë njerëz e Shqyp-tarë. Mos të kungohemi vetëm me hurmt e një zoti që na kufizon e që na zvogëlon. Mos të kërkojmë të mbërthehem me vargonjtë e një tiranie shpirtnore. Të bajmë sa ma shumë dashunorë. Të përqafojmë sa ma shumë mundemi. S'ka Zot tjetër përveç dashunisë, s'ka Dashuri tjetër përveç asaj të Njerëzisë e s'ka Njerëzi pa Atdhe. Ideologjia shqiptare të përmblihet në formulën e madhënueshme të një idealisti shqyp-tar që dikur pat dashtë me vue si paragraf të parë të statutit tonë Kombëtar, "Besoj në Zotin në një të vetëm, besoj në Popullin në një e të pandamë, besoj në Shqipnin, në një e të përjetshme". E vetëm me këtë formulë simbolike t'ideologjisë Shqyp-tare do të mundemi të kapemi për kah nisemi.

\*Botuar më 1936

TË DHËNAT KRYESORE  
MBI JETËN E VEPRËN  
E ZEF MALËS



Zef Mala ka lind me 14 Prill 1915 biri i Gjonit dhe Shaqes. Gojëdhënat thonë se ai ka lindur dhe jetuar deri në moshën 4 vjeçare në lagjen Prandreaj të fshatit Plan, krahinë e Pultit, të Dukagjinit. Gjoni i ati, për të shkolluar fëmijët në kërkim të një jete më të mirë u shpërngul për në Shkodër.

Ne vitin 1933-mbaron liceun në Shkodër në 'Kolegjën saveriane' të Urdhrit Jezuit.

Në vitin 1934-publikon në gazetën "Besa" artikuj tematik mbi shoqëritë rinore dhe shkruan në rubrikën "Jetë shkrimtarësh të mëdhenj". Shfaq mendime letrare për shkrimtarët italo-arbëreshë e bashkëkohorë si: Koliqi, Haxhiademi e të tjerë. Vendoset të jetojë në Tiranë.

Në vitin 1935-boton revistën social-politike "Fryma e re" në Shkodër, ndalohet që në numrin e parë.

Në vitin 1935-1937-redaktor në gazetën "Arbëria", në Tiranë. Bashkëpunon me revistat "Minerva" e "ABC...". Zhvillon temat sociologjike dhe mendimin politik social-kristian.

Në vitin 1937-1938, studion në Uiversitetin e Vienës, në Fakultetin e Filozofisë. Bie në kontakt me teorinë e së majtës Evropine.

Në vitin 1938-kthehet në Shkodër pasi i ndërpritet bursa. Themelon grupin komunist të Shkodrës me ndihmesa Vasil Shanton, Gjovalin Lukën, Niko Xoxin, Tuk Jakovën, Qemal Stafën, e të tjera. Boton materiale propagandistike komuniste e analiza sociale për Shqipërinë. Kritikon sistemin monarkist dhe kërkon organizimin sindikal kundër regjimit.

Dhjetor 1938-nxjerr organin politik të grupit komunist të Shkodrës "Boletini jeshil".

Janar 1939-"Boletini jeshil" arrin në numrin 3. Zbulohet veprimtaria nga Musa Juka dhe arrestohen anëtarët e partisë në gjithë Shqipërinë. Sekuestrohen materialet propagandistike e mjetet e shaptilografimit në Shkodër. Kryetari i partisë Zef Mala arrestohet i fundit si dhe kallëzohet në hetuesi. Cituar në gjyq si i vetmi me arsimim universitar.

11 Shkurt 1939-gjyqi i hapur zhvillohet në Bashkinë e Tiranës. Zef Mala dënohet me 10 vjet burg, me akuzën: 'krijimin e një organizate komuniste e thirrje për rrëzim me dhunë të sistemit kushetues'. Në mungesë të gjetjes së provave për mjetet e dhunës, dënimi nuk shtyhet më tutje nga gjykata duke u konsideruar në tentativë. 10 vjet burg dhe për Vasil Shanton, Niko Xoxin. Shtypi zyrtar ndjek për një muaj në krye të faqeve kryesore procesin e "Gjyqit Politik për propagandë Komuniste" mbi 70 të rinj akuzohen për lidhjet me Zef Malën. Vuan dënimin me punë të detyruar në Breshtan të Beratit.

7 Prill 1939 -bashkë me Vasil Shanton e të tjerë. si marrin vesh arratinë e Zogut, shpërthejnë burgun e nisen që të organizojnë mbrojtjen nga pushtimi fashist në Durrës, por qe vonë.

Nëntor 1939-kapet nga fashistët si organizator i demonstratave dhe internohet për 5 vjet në ishullin famëkeq "Ventotene" dhe në kampin e Santo Stefano-s. Vuan dënimin në shoqërinë e eksponentëve politikë të rezistencës antifashiste italiane, të majtë e demokristianë të De Gasperit;- Sandro Pertini (president i Italisë), Luigi Longo, Pietro Neni, e të tjerë. Thelton studimet. Ruan kontaktet me "Grupin e Shkodrës", dhe mbledh ndihma për të, me anë të P.K. Italiane në Bolonja.

1943 -kthehet në Tiranë nga Internimi në Itali për t'u rigjykuar. Gjykata merr vendimin me 15 vjet burgim. Arratiset me të tjerë nga burgun i Tiranës e futet në batalionin e dytë të Grupit të Pezës ku ndodhej E. Hoxha e M. Popoviçi.

Me 4 Prill 1944- E. Hoxha urdhëron -shokun Nako- "Zef Mala të mos shkojë në Kosovë. Përkundrazi ta dekoroni me një plumb kresë. Ai s'është i mirë dhe duhet të zhduket" (AQSH, fq 14, Dos.76...).

Verë 1944-në një takim në Pezë me Enver Hoxha e Miladin Popoviçin, pyetet nga Miladini për qëndrimin që duhej mbajtur nga komunistët pas luftës ndaj Kosovës.

- Zefi shprehet në takimin me Miladinin e Enverin për "Çështjen e Kosovës do ta zgjidhë populli me zhvillimin e një plebishiti, pas luftës". Po atë natë, në Pezë qëllohet pak kohë pas përfundimit të takimit, por shpëton e largohet natën pas paralajmërimit të Myslym Pezës. (Nga kujtimet e Selfixhe Brojës)

Në vitin 1945-shkon në Itali për të operuar sytë. Bie në kontakt me miqtë antifashistë, tashmë në politikën aktive. Mban një fjalim nga Piacca Venecia, Romë, në mbrojtje të çamëve që masakroheshin nga grekët, pasqyruar në shtypin Italian.

Në vitin 1946, arrestohet papritur, kur punonte në bibliotekën kombëtare, dënohet me 10 vjet burg për qëndrimet politike kundër bashkëpunimit me partinë komuniste jugosllave. Kryen 2 vjet e lirohet nga koniuktura e re kundër Jugosllavisë përmes amnistisë.

Zef Mala, si njeri erudit e njohës i gjuhëve emërohet drejtor dhe themelon në vitin 1949 "Arkivin e Institutit të shkencave", sot Arkivi i Shtetit. Grumbullon gjithë fondet e shpërndarë e të shkatërruar arkivorë në gjithë Shqipërinë dhe i kodifikon sipas sistemit austriak. Fondet e personaliteve të dënuar gjendeshin në wc-të, depot e bodrumet e Ministrisë së Brendshme. Aty dokumentet shtetërore dhe private i kishin hedhur partizanët dhe bastisur Sigurimi i Shtetit, të cilave letër për letër ua gjente rendin vetëm Zefi pasi njihte kaligrafitë e gjithkujt nëpër letrat e shpërndara nëpër plehra e qymyr. Specialistë në arkiv ishin Injac Zamputtilatinisht, Sotir Papahristo-greqisht, Jonuz Tafilaj-turqisht. Për dokumentet gjermanisht-anglisht veçanërisht kujdesej Zef Mala, ndonëse ishte miop e mbante syze me numër 12. Kishte një kaligrafi të imët nga kjo arsye, por të bukur. Zefi krijoi fondet arkivore të Lumo Skëndos, Mirash Ivanajt, Mehdi Frashërit, Mustafa Krujës, Fishtës, Luogo Tenenza-s-'Jakomonit', Lef Nosit dhe të gjithë ministrave që u qenë konfiskuar arkivat. Porosiste vartësit që të kontrollonin dokumente që kishin përfunduar në duart e shitësve të gështenjave dhe kikirikëve në pazar të cilat i kontrollonte imtësisht. Gjithashtu arkivoi kodikët e regjistrat e kishave të Elbasanit Tiranës dhe shkresat zyrtare të Bashkisë të shkruara turqisht e të tjera. Bashkëpunoi me Aleks Budën që ishte shefi i seksionit të Historisë në institut. Zef Mala nisi të blejë për llogari të Arkivit ,materiale të ndryshme nga antikuaristët privatë si, Jashar Erebara, Teki Selenica e të tjerë, për pasurimin e Arkivit të Shtetit»

Në vitin 1950-përgatit një dispencë Historie për Institutin Pedagogjik mbi Shqipërinë e viteve 1912-1924, (e konfiskuar dhe e humbur).

Në vitin 1950-nga martesë, me Afroviti Shahinin i lindin dy vajza, Maria dhe Esmeralda më 1953.

Në vitin 1955-dënohet me 5 vjet burg,

si i dyshuar që të kish lidhje me eksponentë të së majtës në perëndim, nga diktatori.

Në vitin 1958- një delegacion italian dërguar nga L. Longo i kërkon P.P. lirimin e Zefit, ose kalimin e tij në Itali.

Në vitin 1961-64- internohet në Zvërnec të Vlorës në shoqërinë e K. Trebeshinës, S. Gjokës e gazetarit F. Proko. Aty shkroi një traktat filozofik prej rreth 140 faqe të cilin e mori me vete pas dënimit.

Në vitin 1965- e thërret në takim Kryeministri Shehu dhe e paralarmëron: "Po të mos na ngacmohet, as ne nuk do të ngacmojmë më" (Nga kujtimet e Selfixhe Brojës).

Në vitin 1977- e shikon E. Hoxha nga dritarja e K. Q. (sot selia e Kryetarit të Kuvendit popullor) dhe pamja e Zef Malës i duket sfiduese. (Kujton e bija e Zefit, Maria e nipi Lec Mala). Në bulevard sapo binte muzgu, Zefi shëtiste si gjithmonë i vetmuar me një nënqeshje filozofike e sytë depërtues nën lente me skelet të zi. Një xhentëlmen veshur në kostum marron me vijë si Oskar Uajëlld, me bastun e borzalino; ishte ai-filozofi, Zef Mala. Ishte ai që E. Hoxha e sulmonte, me ndihmën e historianëve anonimë, në çdo auditor universitar, në çdo celulë partie e brigadë ferme, për "utopizëm". E internojnë për 5 vjet në Labovën e Zhapës, Gjirokastrë. Diktatori mendoi t'i këmbëjë vendbanimet me Zef Malën që banonte në Tiranë nga viti '34; Filozofin e viteve '30, autorin e 200 shkrimeve vetëm kur ishte 20-23 vjeç. Mandata i feksi diktatorit: Zefi të shkonte në Malin e Gjerë të vendlindjes së tij për ndëshkim, ndërsa të mbetej vetë Hoxha sozia e Zef Malës në...kryeqytetin Tiranë ku s'e njihte kurrkush në vitet '30 si afërmënc, siç do të thoshte Zefi, me gjasë tashmë 'filozof'.

1978- shkruan një PROMEMORIE emblematike Kryeministrit Shehu. Pasi dha të ritë e tij për një të ardhme socialiste arrin në përfundimin: 'Komunizmi si sistem politik është një regres për njerëzimin, është një utopi'. Kërkon largimin nga Shqipëria për të gjetur "Atdheun e dytë" në vendet e demokracisë liberale...

Nuk pranon të votojë në zgjedhjet e vitit 1978. E arrestojnë dhe e dërgojnë në Tiranë, ku ridënohet me 10 vjet burg. E vuan këtë dënim në burgun e Ballshit. Gazetari Foto Proko bashkëvuajtës si në Zvërnec edhe në Ballsh kujton se: "Zefi në burgun e Ballshit u verbua krejtësisht, ecte me shkop dhe e ndihmoja për çdo nevojë". Vitet më të bukura të jetës- sipas Zefit tregon Foto,- ai i kish kaluar në 5 vitet e internimit në Itali ku rivalizonte në studimin në bibliotekë me Nenin, Longon, Pertinin, të cilët e vlerësuan aq sa të dërguarit e Luigi Longo-s pranë Tiranës zyrtare në vitin 58 kërkuan: "ose lironi Zef Malën ose na e përcillni në Itali se e duam ne". Kjo kërkesë nga e majta italiane i kushtoi, sipas bisedave me Foton, një përndjekje më të egër ndaj Zefit. U mësonte të dënuarve gjuhë të huaja, ndërsa Fotoja ia lexonte librin "Lufta e paqja" të Tolstoit. Zefi deri në fund ruajti optimizmin dhe besimin se diktatura do të rrëzohej dhe e vërteta do të triumfonte.

Me 26 Dhjetor 1979-vdes në spitalin e burgut në Tiranë me bindje social-demokrate liberale siç deklaroi vetë në PROMEMORIE.

Urdhërese nr. 21 date 8/6/1949, bën fjalë për krijimin e Arkivit të Shtetit. Ky institucion e kishte varësinë nga Kryeministria, Drejtor u emërua Zef Mala, i cili për shkak të kulturës dhe vizionit që kishte, luajti një rol shumë pozitiv në themelimin dhe projektimin e së ardhmes së këtij Institucioni." U shpreh Gjet Ndoj, Drejtor i Përgjithshëm i Arkivit të Shtetit.

## TESTAMENT POLITIK PROMEMORIA E ZEF MALËS DREJTUAR KRYESISË SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, MEHMET SHEHUT

### Labovë, Gjirokastrë 15 korrik 1978

Në bazë të një vendimi të Komisionit të internimeve ndodhem në Labovë familjarisht i dënuar me 5 vjet banim të detyrueshëm këtu, për qëndrim të keq politik.

Kundër këtij vendimi të pajustificueshëm në planin juridik e legal, dhe të pa drejtë në atë etik e politik, paraqes protestën time. Sepse qysh nga vjeti '41 nuk kam zhvillue ma, asnjë aktivitet politik e shoqëror, bile sistematikisht i jam shmangë edhe çdo veprimtari kulturore publike, duke dashtë me evitue çdo fërkim me autoritetet në fuqi.

Rritë e edukue në një rreth familjar i cili dikur pat dhanë kontributin e vet, si në beteja për pavarësi ashtu dhe ma vonë, për liri e demokraci.

Kam nisë veprën time politike e kulturore qysh në moshë shumë të re në mbrojtje të këtyne idealeve dhe në favor të një rendi shtetëror të themeluar mbi drejtësinë dhe në të cilin burgjet dhe kampet e internimit do të ishin vende koreksioni e riedukimi të vrasësit, grabitësit dhe shkelësit ordiner të ligjit. Megjithëse përmes pasigurish e lajthitjesh të kuptueshme për moshën djaloshare, jam gjende në mes, dhe në krye të lëvizjes përparimtare që proçeduan krijimin e Partisë Komuniste dhe ardhjen e saj në fuqi. Pothuaj për 10 vjet me radhë shkrimet e mija, artikujt e mi të shumtë, broshurat, përkthimet e te tjera legale e ilegale kanë qenë baza e vetme teorike dhe materiali kryesor propagandistik i të ashtuquajturve "Grupe Komuniste".

Nën ndikimin tim grupet e masipërme muarën atë orjentim antimonarkist dhe antikonformist, për të cilën krenohen sot, edhe ata që atëherë i qenë nënshtruar sistemit duke përfitue nga beneficet që mbreti u blatonte me bujari gjithë atyne që i shërbenin në mënyrë të hapët ose të mshehtë\*. Gjithashtu nën drejtimin tim qysh më 1939 nisi lufta e organizueme e popullit Shqiptar kundër okupacionit italian, ndërsa të tjerët prisnin sulmin Gjerman, në bindje për të kuptuar se edhe atdheu ynë ishte viktimë e agresionit Fashist. Demonstratat e 39-ës janë kryesisht vepra ime. Për afro 10 vjet me radhë mendimet e mia dhe puna ime i dhanë tonin lëvizjes revolucionare të grupeve progresiste, pa më guxue askush të m'i kundërshtojë gjatë të gjithë kësaj kohe, me dy rrjeshta të shkrueme ose me dy thanie verbale të vërtetueshme.

**Gjon Fierza**

(vijon në numrin e ardhshëm)

# SHKODRA SOT HUMBI LEGJIONARIN VESHUR ME TUNIKË TË BARDHË POETI

NJË LULE LOTI PER SKENDER TEMALIN



SKENDER TEMALI  
Shkrimtar

Koleg publicist, poet e prozator!  
Lexues dhe dashamirë të fjalës së mirë shkruar!

Familja jonë e madhe sot humbi legjionarin e vjetër veshur me tunikë të bardhë poeti .

Një penë e skalitur në zjarrin vullkanik të hove të larmishme poetike, sot mbeti e ve!

Një shigjetë e fluturuese publicistike humbi harkëtarin e moçëm.

Muzat rrezatave nder yje u veshën në zi per këngëtarin dhe dashuruesin e madh të natyrës jetës dhe stinëve.

Një luftëtarë i së mirës, virtytit, fisnikërisë, progresit, arsimit dhe menaxhimit të jetës kulturore artistike, sot ra në fushë e luftës së tmerrshme të Pandes-

misë. Përgut disa mirash të të shytuarve nga kjo bombë, sot ju shtua edhe Skender Temali. Dhimbja është e thellë, njerëzore dhe trishtuese, mbasi ike bash në kohën kur njerëzve u erdhi shpresa se u gjend ilaçi i shumë prituri i kësaj të mallkuare të përbotshme. Ju ishit akoma në një moshë aktive fizike e krijimtarie. Ju ishit akoma i dobishëm dhe model jo vetëm per familjen tuaj biologjike, por edhe per familjen tonë krijues. Ju ishit bujk i vjetër fjalës artistike dhe mendimit të lirë intelektual të qytetit tonë. Në kemi plot shqiptarë të larë në “arë” pasurie, pushteti, fuqie madhështore, demagog të pa atdhe, pa Zot as fe që janë shitë e leçitë si derrat në teqe.

Por në anën tjetër kemi fort më shumë shqiptarë të thjeshtë, të bindur, punëtorë,

që u rrahë zemra çdo çast vetëm për mirësi, drejtësi shqiptari e përparim.

Gjithë jetës u gjende në pararojë të pjesës më të shëndoshtë të shqiptarëve si shëlbues i shpirtit, mendje e syve të terratur nga pa dituria dhe e liga.

Ju ishit shëmbëllimi i njeriut të përkushtuar, punëtorë, imponant, por mbi të gjitha i dashur, njerëzor, korrekt, mësuës dhe kritik i mirë ndaj të rive.

Ju ishit gjithmonë përbashkues jo pykë përçarëse, zjarrfikës jo benzinëdhëhës, racional jo nihilist, tolerant, por jo derëshqyer ndaj parimeve eprore morale dhe artistike.

Ju sot po largoheni fizikisht nga familja, miqësia e shoqëria, të afërmit dhe koleget që të deshën dhe i deshe. Ike pa

pritur dhe në magjen tënde krijuese, le duke u mru bukë pagaçe, simite dhe pite me fruta të rrëshinuara. Ike, por na le dhuratë testamentin tënd letrarë, që bën nder Shkodrës!

Kjo mjegull e zyrtë që i varavitet deri nën gërliqe Taraboshit është lajmi i trishtueshëm se, Shkodra sot humbi një poet. Ky shi i cigramtë mes shengjergjash, është loti ujëvarë i muzave per dashnorin e tyre romanik. Kjani ju lule nder kopshte për bilbilin që këndoi per ju pa ja nda! Jo qyqe! Jo kurrë, por bilbila, nesër dhe në vijim këndon këngët që la buqetë poeti!

Lamtumire poeti Skender Temali!

Prele Milani

## Të rinj për një shkollë të re

### LOZIM ME LETRA HAPUR

Në përgjithësi, këto vitet e fundit është vërtetuar qartë një situatë e rëndë në nivele të ndryshme të vendit tonë. Ajo që më shumë duket se po e rëndon dhe që po e bren popullin nga brenda është realiteti shkollor. Me pak fjalë, kemi parë besoj të gjithë, se nga bankat e shkollave tona po dalin njerëz pa një përgatitje të mirëfilltë shkencore.

Kur ballafaqohemi me gjendjen, duket sikur të gjithë duan të ngrenë supet duke shprehur një mospërfillje, duke mos ditur kështu kujt t'i drejtohem për të përmirësuar. Nuk dihet se kush e ka fajin? Cilat janë shkaqet? Ku kemi qenë deri tani?

Pasojë e një historie të dhimbshme që ka kaluar tashmë, shkolla tek ne ka rënë, është përlurur, ka humbur dinjitetin dhe vendin që i takon.

Ndërsa në të katër anët hidhet kush-

trimi për një ndjeshmëri më të madhe të arsimit të djemve e vajzave shqiptare, shkolla vazhdon të ketë atë gjendjen e saj të mjerueshme.

Banka, dritare e dyer të shkatërruara, mure të zhargavitura si shtëpi të pazot, nxënës e njerëz që hyjnë e dalin sipas qejfit, i japin realitetit shkollor një pamje vërtet kritike.

Rrjedhjet dihet se duhet të jenë tepër të rënda: pa një formim bazë njerëzor, do të jemi kështu siç jemi e madje edhe më keq.

Qeliza të gjalla për një shoqëri të gjallë

“Në mes të këtij tufani të tmerrshëm qi po e trandë anekand jetën shqiptare, ndërsa shoh... ata qi n ‘ëmën t ‘idealit e të kombisë nuk po lanë gja pa përmbysë, rrij e përgjoj e me kënaqësi të madhe ndiej një za zemre, gjamën e shpirtit të disa shqiptarëve vërtet fisnikë, të cilët tue

u naltue mbi këtë shëmtim, mbërrijnë aty ku janë vlerat e visaret e jetës njerëzore e shqiptare, dhe me të tana ndiesitë nuk flasin, por si vigaj ulurojnë, zani i tyne asht kushtimi për kulturën e shpirtit shqiptar” (At Anton Harapi, Vlerë shpirtërore, Kontribut për trajtimin mendor të shqiptarit, Hylli i Dritës, Tiranë 1994, fq. 154).

Rinia studentore, djem e vajza të të gjitha shkollave, me një bashkëpunim të harmonishëm me prindërit e familjet, është e mundur të jenë qeliza të gjalla për shoqërinë shqiptare... Qeliza të gjalla, pra, për një Shqipëri të gjallë, për një shoqëri më të mirë.

Një rol të rëndësishëm përballë kësaj situatë e kanë mësuesit, të cilët shpeshherë nuk kanë aftësinë të kryejnë detyrën e tyre kaq fisnike në formimin e të rinjve tanë.

Për këtë arsye, në emër të të rinjve shqiptarë, me të cilët deri tani kam punuar, ftoj të gjithë ata që japin mësim në shkoll-

lat tona, të përipien ta mbajnë me nder këtë detyrë të shenjtë që u është besuar!

Ju bëj thirrje, veçanërisht studentëve, të bëjnë ç’është e mundur të përmirësohet gjendja duke e ditur se ata vetë janë protagonistët e parë në këtë ecje. Edhe në Bibël e në kulturën e të gjithë popujve, ideja për përparim është një temë themelore. Në fakt, shën Pali Apostull, kështu na drejtohet: “Prandaj, vëllezërit e mi të dashur, të jeni të qëndrueshëm, të palëkundshëm e përparoni vazhdimisht në veprën e Zotit, të vetëdijshëm se munda juaj nuk mbetet i pafrytshëm në Zotin”. (1 Kor. 15, 58) Dhe përsëri: “...vëllezër, ju nxisim që në këtë gjë të përparoni gjithherë e më tepër...” (1 Sel. 4, 10).

Me ardhjen e demokracisë në Shqipëri, duket sikur të gjitha energjitë e popullit tonë janë fokusuar në një përparim material, në një vrapim të shfrenuar pas teknologjisë, duke lënë kështu pasdore “përparimin moral, shpirtëror dhe intelektual”.

Që në vitin 1967, Pali VI e shihte si të domosdoshëm, shqyrtimin e zhvillimit të popujve nga ana e


# Mark Palnikaj: Klerikët hapën shkollat 800 vjet më parë

Eneida Jaçaj

Mark Palnikaj zbulon dokumentet e Vatikanit: Gjuha shqipe është shkruar para Kongresit të Manastirit, klerikët hapën shkollat 800 vjet më parë

**bashkëbisedoi: Eneida Jaçaj**

Mark Palnikaj është një nga studiuesit më të zellshëm të dokumenteve të hershme shqipe, në arkivat e Vatikanit, Venecias, Napolit, e të tjera. Palnikaj është mjaft i apasionuar dhe i palodhur, në zbulimin dhe studimin e dokumenteve të vjetra shqipe, përmes të cilave ka gjetur prurje të reja për gjuhën shqipe dhe ka realizuar mjaft shkrime e libra në lëmin e historio-grafisë. Studiuesi Mark Palnikaj ka zbuluar një sërë dokumente në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të huaj, në arkivat e bibliotekave perëndimore, dokumente, të cilat plotësojnë thesarin e historisë shqiptare të mesjetës. Me gradë doktor i inxhinierisë mekanike, ku ka botuar një sërë librash edhe në këtë fushë, Mark Palnikaj e kalon kohën e tij duke shfletuar e studiuar dokumente të hershme, që do të shërbejnë si referencë edhe për studiues të tjerë. Me krenari duhet të pranojmë se në bibliotekat perëndimore gjenden dokumente të kahershme shqipe, që do të thotë sesa e vjetër është gjuha dhe ekzistenca e arbrit, dhe gjithashtu se jemi një popull me histori të vyer. Në një intervistë ekskluzive për gazetën "Dielli", New York, Mark Palnikaj, deklaroi se në bazë të kërkimeve që ka kryer, ka zbuluar se gjuha shqipe është shkruar para mbajtjes së Kongresit të Manastirit 1908, 49 vjet para zyrtarizimit të abetares së unifikuar. Zyrtarisht ne jemi të informuar se shkolla e pare shqipe është hapur në Korçë, por Palnikaj ka zbuluar se shkollat shqipe janë



hapur 800 vjet më parë, nga klerikët. Dua të theksoj se Mark Palnikaj bën kërkime të vazhdueshme me karakter historik, në Arkivin e Shtetit në Venecia (Archivio di Stato di Venezia), në Arkivin e librave dhe dokumenteve antike në Padova (Biblioteca Antica del Seminario Vescovile di Padova), në Arkivin ASSC (Arkivi Historik dhe Biblioteka Shtëpia e Shenjtë) në Loreto, në Bibliotekën Komunale (Biblioteca Civica "Romolo Spezioli") në qytetin e Fermo, në APF (Archivio Storico di Propaganda Fide) në Romë, në ARSI (Archivum Romanum Societatis Iesu) në Vatikan, ASV (Archivio Segreto Vaticano), në Bibliotekën Apostolike (Biblioteca Apostolica Vaticana), në Arkivi e Manastirit të Grottaferrates (Archivio monastico dell'Abbazia territoriale di Santa Maria di Grottaferrata), në Arkivin e Shtetit në qytetin e Napolit (Archivio di Stato di Napoli) dhe në BNL, arkivin e Bibliotekës Kombëtare në Napoli (Biblioteca Nazionale di Napoli). Ka kryer kërkime edhe në AQSH (Arkivi Qendror të Shtetit Shqiptar), në arkivin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë dhe në disa arkiva kishtarë dioqezane.

**Ju jeni një nga studiuesit më të zellshëm të dokumenteve të hershme shqipe në bibliotekat perëndimore. A**

Kishës. Ndër të tjera pohonte: "... rritja ekonomike është e lidhur para së gjithash me përparimin shoqëror, që ajo është në gjendje të ngjallë, dhe se edukimi bazë është pikësynimi i parë i një plani zhvillimi. Uria për arsimim në realitet nuk është më pak e trishtueshme, sesa uria për ushqim: një analfabet është një shpirt i keqshqyer. Të dish të lexosh e të shkruash, të marrësh një formim profesional do të thotë të rifitosh besimin në vetvete dhe të zbulosh se mund të përparosh së bashku me të tjerët". (Pali VI, Zhvillimi i popujve, nr. 35.)

Në këtë mënyrë do të mundësojmë një terren më të mirë që me të vërtetë të jemi qeliza të gjalla në këtë shoqëri, që kaq shumë ka nevojë të ngrihet në vendin e duhur.

**Të kërkojmë rrugë të reja!**

Gjithë kjo kërkon punë, kërkon një vepër të vazhdueshme që nis me vrullin e fillimit e që mbart në vete shpresën me një shikim të largët.

Është e nevojshme më shumë se asnjë

jëherë të kërkojmë së bashku rrugë të reja, origjinale, të përshkueshme për ne e për njerëzit që si turmat pa bari presin të kenë udhëheqës të mirë, leaders të aftë të mbajnë në dorë situatën.

Kam shumë besim e optimizëm se duke bërë kështu e duke ecur me qëndrueshmëri e në mënyrë heroike do t'ia arrijmë.

Është një sfidë, ndonëse e vështirë! Por është e bukur, e shkëlqyeshme, e zjarrtë si një diell, që edhe pse përtej malit sigurisht është i ndezur e bën dritë...

Ka ardhur momenti të provojmë. Pa frikë! Zoti është me ne miq të rinj edhe nëse njerëzit ose koha, ose pasiguria jonë do na bëhen pritë. Ne mund të çajmë përpara. Kurajo, Zoti është me ne! Do të jemi kështu të rinj e të reja, që së bashku hapin një rrugë të përshkueshme edhe për të tjerë që kanë humbur orientimin.

Të nisim që nga shkolla duke pasur parasysh se "Çdo ndërtesë i vihen themelet në dhë. Edhe në vorr, prandej, në hijshim, duhet të jemi gurt e themelit të njaj binaje të cilën sot e quejmë Shqipni".

**Nikolin Sh. Lëmezhi**

**ka dokumente shqipe në sasi të konsiderueshme në arkivat e Vatikanit, Napolit, Venecias e të tjera, atje ku ju kryeni studime?**

Objekt i studimeve të mija, në arkivat italiane dhe austriake, ka qenë historia e Shqipërisë, nga mesjeta deri në ditët e sotme. Dokumentet, në masën më të madhe, janë të shkruara me dorë dhe në gjuhë të huaj, por vazhdimisht kam gjetur edhe shkrime në gjuhën shqipe. Nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, shkrime në gjuhën shqipe gjenden me shumicë në këto arkiva. Të rëndësishme janë shkrimet nga shekulli XV deri XIX, të cilat janë në numër më të pakët, por ka vijimësi në shkrimet shqipe gjatë gjithë këtyre shekujve. Po ju përmend ato më të rëndësishmet:

- Formula e pagëzimit, shkruar nga Pal Ëngjëlli, në vitin 1462;
- Fjalorthi i Arnold Von Harfit i vitit 1497;
- Shkrimet e Lek Matrëngës, në vitin 1592;

**- Perikopeja e Ungjillit të Pashkës** (fundi i shekullit XV-fillimi shekullit XVI);

- Poezi nga Pal Hasi, para vitit 1618;
- Poezi nga Pjetër Budi, viti 1618;
- Fjalori i Frang Bardhit i vitit 1635;
- Gramatika e Ndre Bogdanit, rreth vitit 1650;

- Çeta e Profetëve e Pjetër Bogdanit, përfunduar në vitin 1675 dhe botuar në vitin 1685;

- Letra e Krenave të Gashit, shkruar nga Gjergj Toliqi, me datë 2 maj 1689;

- Fjalori i Françesko Marias nga Leçe i vitit 1702;

- Kongresi i Arbrit - përkthyer në gjuhë shqipe në vitin 1706;

- Fjalori anonim Italisht-Shqip i vitit 1710;

- Gramatika e Françesko Marias nga Leçe e vitit 1716;

- Dorëshkrimi i Kieutit (1736);

- Gjon Nikoll Kazazi (1743);

- Jul Variboba (1762);

- Dom Pal Zogaj, Gramatika 1776.

Këto vitet e fundit kam gjetur dhe publikuar edhe tre shkrime të tjera në gjuhën shqipe:

- Një faqe e shkruar nga Frat Onofrio nga Bernarda e Basilikatës në gjuhën shqipe, në regjistrin e famullisë së Shalës, në vitin 1778.

- Një kontratë midis kishës dhe një besimtari në famullinë e Nikajve shkruar me datë 8 maj 1859.

- Një vendim i shkruar në fshatin Peraj të famullisë së Nikajve, shkruar në vitin 1881.

Këto tre shkrime të fundit i kam publikuar në gazetata e kohës, katër vitet e fundit.

Kërkesa për të shkruar në gjuhën shqipe nxiti patriotët që në harkun kohor të gjashtëdhjetë viteve u shkruan tetëmbëdhjetë tekste abetaresh si më poshtë:

- Naum Veqilharxhi: "Fare i shkurtër e i përdorçim Ëvetar shqip" (1844, 1845);

- Panajot Kupitori: "Abetare e gjuhës shqipe" (1860);

- Anastas Byku: "Gramme për shqiptarë" (1861);

- Konstandin Kristoforidhi: "Abetare skip" (1867, 1869, 1872);

- Daut Boriçi: "Abetare shqip" (1869);

- Vasil Dhimitër Ruso: "Pellazgjika shqip alfavitare", Bukuresht 1877;

- Jani Vreto: "Alfabetare e gjuhës shqipe", Kostantinopojë 1879;

- Anastas Kullurioti: "Abetaretarë" (1882);

- Sami H. Frashëri: "Abetare e gjuhës shqip", (1886, 1888, 1900);

- Jovan Risto Tërova: "Abetarea shqipe", Bukuresht 1887;

- Gaspër Benusi: "Abetare e gjuhës shqipe", Bukuresht 1886, 1890;

- "Abetari i qitun pri shoqnet t' Bashkimit t' giuhes shqype", Shkodër 1899

- Said Najdeni: "Abetare e gjuhës shqipe", Sofje 1900;

- Shtjefën Gjeçovi: "Abetarja e Zymit" (1900);

- Ndre Mjeda: "Këndime për shkollë të para", Vjenë 1904;

- Luigj Gurakuqi: "Abetari për mësoitore filltare t' Shqypnis", Napoli 1905, Bukuresht 1906

- "Abetare toskërisht, pas abecesë së vjetrë të Stambollit", Sofje 1908

- "Abetare gegërisht, pas abecesë së vjetrë të Stambollit", Sofje 1908.

Botimi i këtyre abetareve, nën terrorin e sundimit turk, ka qenë një punë e sforcuar që atdhetarët tanë e kryen me sukses, në më të shumtën e rasteve, jashtë atdheut nga diaspora patriotë.

Përveç shkrimeve të prezantuara më sipër, janë edhe një numër jo i vogël i shkrimeve shqipe në arkivat italiane dhe të vendeve të tjera, që besojmë t'i publikojmë më vonë.

**Një nga prurjet tuaja më të reja është libri "Skënderbeu, letërkëmbimi me sulltanët". Ku konsiston ky libër, çfarë të reje keni sjellë në historinë mesjetare për heroin Gjergj Kastrioti-Skënderbeu?**

Këtë libër e kam botuar me rastin e kremtimit të 550 vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, dhe e kam paraqitur në konkursin e organizuar me këtë rast, për librin anastatik më të mirë. Kam marrë në Arkivin Sekret të Vatikanit letërkëmbimin e Skënderbeut me sulltanët dhe letrën e Skënderbeut, dërguar Papës, nga Kepi i Rodonit, me datë 29 tetor 1462. Në ato letra shpalosen qartë aftësitë jo vetëm luftarake, por edhe diplomatike të Skënderbeut, në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ky libër është një shembull i mirë edhe sot për politikanët e rinj, për të marrë eksperiencën se si duhet të jetë gjuha dhe komunikimi në marrëdhëniet ndërkombëtare

midis shteteve.

**Gjuha shqipe, me bazë indoevropiane, është një nga gjuhët më të vjetra, ndoshta e vetmja gjuhë më e vjetër e globit. Mendohet se pas themelimit të alfabetit në Kongresin e Manastirit të vitit 1908, ka nisur të shkruhet gjuha shqipe. Por, nga kërkimet tuaja, a jeni ndeshur me dokumente që faktojnë periudhën e saktë se kur është shkruar shqip?**

Ka dokumente të pakundërshtueshme që edhe para vitit 1462 është shkruar në gjuhë shqipe, por me alfabetin latin. Shkrimi më i vjetër që është gjetur deri më sot i shkruar në gjuhën shqipe, është formula e pagëzimit e përmendur më sipër.

**Meshari i Gjon Buzukut i vitit 1555 zyrtarisht është libri i parë i njohur i përkthyer në gjuhën shqipe. Çfarë rëndësie ka ky libër në historinë e Shqipërisë?**

Meshari i Gjon Buzukut është libri i parë i njohur i shkruar në gjuhën shqipe, por kjo nuk do të thotë që nuk ka pasur edhe më parë libra të shkruar në gjuhë shqipe. Është jashtë logjikës të pranohet që një prift në fshatin Bria të Krajës, të ketë marrë iniciativën e shkruarjes së librit të parë në gjuhën shqipe. Libri edhe ashtu siç është ka formë të rregullt dhe nuk mund të konfigurohej si i tillë po të mos ekzistonin modele edhe para tij. Besohet se motivi që e ka shtyrë Gjon Buzukun për shkrimin e këtij libri, ka qenë fryma e re e protestantizmit që po përhapej në Evropën e shekullit XVI, për të shkruar biblën në gjuhët nacionale të kombeve të ndryshme, pasi gjuha latine nuk kuptohej nga masat e gjera të besimtarëve. Edhe më vonë, klerikët e tjerë bënë çfarë ishte e mundur për të përhapur shkrimet shqipe dhe për të bërë të mundur mësimin e gjuhës së shkruar shqipe nga shqiptarët dhe të huajt, midis të tjerave, sepse duke mos njohur gjuhën shqipe, klerikët ishin të detyruar të merrnin një përkthyes për të dëgjuar rrëfimin e besimtarëve dhe fshehtësia e sekretit të rrëfimit nuk ishte e sigurt kur merrej vesh nga më shumë se një person. Rëndësia e dytë e këtij libri është që ne kemi në formë të dokumentuar gjuhën e folur në shekullin XVI, dhe është e mundur të studiohet në mënyrë shkencore leksiku i gjuhës shqipe të kohës. Ne nuk e dimë se si e ka folur gjuhën shqipe heroji ynë kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Sot, gjuha ka ndryshuar shumë dhe nëse do të kishim një libër të shkruar në gjuhë shqipe të asaj kohe, ne do të mësonim shumë gjëra për të folurën e gjuhës shqipe.

**Shqipëria ka qenë nën sundimin osman 5 shekullor, ku Porta e Lartë e ka penguar gjuhën shqipe dhe hapjen e shkollave shqipe. Nga ana tjetër kemi edhe përpjekjet e mëdha të patriotëve, të cilët nuk kanë rreshtur së lobuari për çlirimin e vendit dhe kanë luftuar që gjuha shqipe të mos humbasë. A ekzistojnë dokumente se kur janë hapur shkollat e para shqipe, dhe në cilat qytete?**

Shkollat e para në Arbëri dhe në zonat përreth, ka të dhëna se janë hapur në shekullin e trembëdhjetë dhe më parë, pra rreth 800 vjet më parë. Për këtë ka burime të shkruara të sigurta dhe flitet se kanë funksionuar edhe universitete në qytetin e Durrësit dhe në disa qytete të tjera të Il-

irisë mesjetare. Në atë kohë, arsimit ishte privilegj i të pasurve dhe ishte me pagesë. Bazat e arsimit modern që kemi sot i vendosën priftërinjtë benediktin në fillim të shekullit XVI. Në vitin 1502, ata paraqitën platformën e tyre për arsimimin e popullsisë bazuar në tre parime:

- Arsimi fillestar duhet të ishte falas.
- Duhet të ishte i detyruar dhe për të gjithë fëmijët.
- Duhet të kishte programe unike për shkollat fillestare.

Bazuar në këto parime, ka të dhëna se shkolla e parë në gjuhën shqipe është hapur në komunën e Letnicës, në Stubëll në vitin 1584.

Më vonë, në vitin 1632, në fshatin Galatë të Kurbinit është hapur shkolla nga Gjon Kolesi. Në këtë periudhë u hapën edhe në Mirditë shkolla e Velës dhe ajo e Oroshit. Në vitin 1675, në fshatin Rrjoll të Malësisë së Madhe, Pjetër Bogdani ka hapur shkollën shqipe me mësues Marin Gjini. Në vitin 1698 gjendet e hapur një shkollë shqipe në Shkodër nga Fra Filipi dhe rreth vitit 1750, shkolla e Topanasë në qytetin e Shkodrës. Nëse marrim parasysh faktin se Pali nga Hasi dhe Pjetër Budi kanë shkruar poezi në gjuhën shqipe qysh para vitit 1620, dhe Frang Bardhi ka shkruar fjalorin Latinisht-Shqip në vitin 1635, duhet të besojmë se ka pasur edhe shkolla të tjera në gjuhën shqipe përveç atyre që u përmendën më sipër, por duhen kryer kërkime dhe studime këmbëngulëse për të gjetur dëshmitë e nevojshme për këtë. Mbas viti 1479, turqit kishin pushtuar pothuajse tërësisht Ilirinë dhe deri në shekullin XVIII, hapja e shkollave në qytete ka qenë e ndaluar. Prandaj, ato u hapën kryesisht në kishat e famullive në zonat fshatare si Kurbini, Pllana, Velja, Oroshi, Rrjollit e të tjera. Është me rëndësi dhe interes për t'u shënuar se në mesin e shekullin XVII, rreth vitit 1650, në Janjevë ka pasur shkollë shqipe, e cila përgatiste kandidatë për të vazhduar studimet në Kolegjin Ilirik të Loretos, të Feros dhe të Kolegjit Urban të Vatikanit. Në vitin 1675 rezultoi që në këtë shkollë të jetë një klasë me 25 nxënës, tre nga të cilët nga familja Bogdani e Hasit.

**Ju thatë se shkollat e para janë hapur nga klerikët. Përveç mësimin të gjuhës shqipe, kjo ka ardhur që shqiptarët të mos konvertoheshin në besimin islam për shkak të sundimit otoman. Ju nga zbulimet tuaja, çfarë kanë gjetur?**

Në mesjetë, deri në shekullin XVIII, shkollat në të gjithë Evropën janë hapur nga klerikët. Kjo ka ndodhur sepse vetëm ata kishin personel të arsimuar për të mundësuar hapjen e shkollave.

Në Shqipëri, edhe në shekullin XX, shkollat në Gomsiqe, Theth, Gjonpepaj dhe shumë vende të tjera shkollat fillore i kanë hapur klerikët si Shtjefën Gjeçovi, atë Nikoll Kolaj e të tjerë. Mbas shpalljes së pavarësisë, nga viti 1916 deri në fund të vitit 1918, nën mbikqyrjen dhe me ndihmën e Perandorisë Austro-Hungareze, u hapën në Shqipëri 432 shkolla në gjuhën shqipe. Austrohungarezët, në kuadri e Kultprotectoratit, ose e thënë ndryshe në kuadrin e përkujdesjes për mbrojtjen e kulteve në trojet arbërore, u kujdesën gjatë tre shekujve për kultivimin e gjuhës dhe kulturës arbërore. Tri ngjarje me shumë rëndësi për gjuhën dhe kulturën shqipe, hapja e Kolegjit Saverian të Shko-

drës në vitin 1877, Kongresi i Manastirit i vitit 1908 dhe Komisia Letrare e krijuar në Shkodër në vitin 1916, janë realizuar me ndihmën teknike dhe financiare të Perandorisë Austro-Hungareze. Hapja e shkollave të para në Arbëri dhe Dardani, kishin rol të madh në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqipe, por zyrtarisht, ato nuk kanë pasur qëllim për të frenuar islamizimin e shqiptarëve, edhe pse indirekt kanë pasur një ndikim të tillë. Zyrtarisht, ato janë hapur për nevojat e shkollimit të klerikëve dhe për dhënien e liturgjisë në gjuhën shqipe, por, ato kanë pasur ndikim të madh edhe në ruajtjen e identitetit dhe vetëdijes kombëtare. Rol shumë të madh në shkrimin dhe përpunimin e gjuhës shqipe, ka pasur diaspora shqiptare dhe më së pari arbëreshët në Jugun e Italisë dhe në Sicili dhe më vonë, diaspora në Rumani, Egjipt dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

**Cilët ishin të parët që u bënë protagonistë në themelimin e gramatikës së gjuhës shqipe? Cili mbahet si babai i gramatikës së gjuhës shqipe?**

Protagonistet e parë për hartimin e një gramatike të gjuhës shqipe në historinë mijërvjeçare të kombit tonë, janë dy klerikë nga Hasi, Ndre Bogdani nga fshati Gjonaj i Hasit, dhe Pal Zogaj nga fshati Bria i Hasit. Ka të dhëna të pakundërshtueshme se Ndre Bogdani e shkroi gramatikën e parë të gjuhës shqipe para vitit 1670 dhe Pal Zogaj e shkroi një gramatikë të gjuhës shqipe në vitin 1776. Fatkeqësisht nuk kemi asnjë kopje të asnjërës nga këto dy gramatika, por besohet se Pjetër Bogdani kur ka shkruar librin Çeta e Profetëve, të cilin e ka botuar në vitin 1685 në kolona në dy gjuhë, italisht dhe shqip, është ndikuar nga gramatika e shkruar nga xhaxhai i tij, Ndre Bogdani dhe nga fjalori latinisht-shqip i Frang Bardhit. Babai i gramatikës së gjuhës shqipe duhet të konsiderohet frati italian, Françesko Maria nga Leçe, i cili ka shkruar dhe ka arritur të botojë gramatikën që mban emrin e tij në vitin 1716. Kjo gramatikë përmban 228 faqe dhe për nga nivelin shkencor, konkurren me çdo libër gramatikë të gjuhës shqipe të shekullit XXI.

**Meqenëse gjuha shqipe është shkruar më herët sipas dokumenteve të zbuluara, a ka ekzistuar alfabet para atij të Manastirit 1908?**

Po, kanë ekzistuar disa alfabetë. Gjuha shqipe ka një numër të madh tingujsh ose fonema siç i quajmë gjuhëtarët dhe e bënë të vështirë shkrimin e saj pa një numër të madh germash. Gjuha latine shkruhet mjaftueshëm me ndihmën e 28 germave, kurse për gjuhën shqipe nuk mjaftojnë kaq germa. Megjithatë gjuha shqipe ka filluar të shkruhet së paku 800 vjet më parë, ajo në fillimet e saj është shkruar duke përdorur alfabetin latin, me disa shtesa nga germa të huazuara nga gjuhë të tjera. Me këtë problem është marrë në mënyrë të hollësishme studiuesi Robert Elsie dhe ai ka identifikuar 10 alfabetë të gjuhës shqipe të përdorur para alfabetit të Kongresit të Manastirit. Besoj se lexuesit tanë janë të njohur me punimet e Elsit, prandaj nuk e shoh me interes të zgjatëm në këtë pikë.

**A mund të bëni një krahasim midis diasporës së hershme shqiptare dhe asaj**

**të sotme? Çfarë i afron apo i veçon këto diaspora në kohë të ndryshme?**

Për të shkruar për diasporën shqiptare do të duheshin volume të tëra me libra, sepse nuk ka vend në të gjithë botën ku nuk ka banorë të kombësisë shqiptare. Në historinë tonë kombëtare, ndikim të dukshëm ka pasur diaspora shqiptare, nga shekulli XVII deri në vitin 1920. Në këtë periudhë, shqiptarët e vendosur në Stamboll, në Egjipt, në Rumani dhe sidomos në Boston të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kanë dhënë një ndikim shumë të madh në ngritjen e vetëdijes dhe identitetit kombëtar. Ata kanë formuar shoqata të cilat kanë bërë botimet e para në gjuhën shqipe, kanë botuar gazeta të cilat patën ndikim shumë të madh për zgjimin kombëtar, kanë mundësuar shkollimin e një numri të madh shqiptarësh me arsim bashkëkohor. Personat e shkolluar patën ndikim të madh në drejtimin e lëvizjes për liri dhe pavarësi të shqiptarëve. Janë për t'u përmendur në atë kohë persona si Spiro Risto Dine në Egjipt, vëllezërit Frashëri në Kostandinopojë, familja Gjika në Bukuresht, Fan Noli, Faik Konica dhe atdhetarë të tjerë në Boston. Arbëreshët e Italisë, me Jeronim de Radën dhe, më vonë, Luigj Gurakuqi dhe shumë të tjerë, të cilët bënë punë të madhe për lëvizimin e gjuhës shqipe. Terenc Toçi, në fillim të shekullit XX punoi shumë për shpalljen e pavarësisë, i cili në prill të vitit 1911 formoi qeverinë e Kimzës në Mirditë dhe ngriti flamurin shqiptar. Preludi i të gjitha këtyre përpjekjeve ishte shpallja e pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912. Deri në shpalljen e pavarësisë, qëllimi kryesor i diasporës shqiptare ka qenë krijimi i vetëdijes kombëtare dhe çlirimi i vendit.

Mbas krijimit të shtetit funksional shqiptar në Kongresin e Lushnjës në janar 1920, diaspora ka marrë një karakter tjetër. Tashmë problemi kombëtar ishte zgjidhur, kufijtë u vendosën dhe diaspora merr më tepër rolin e një opozite demokratike, me qëllim vendosjen e sundimit të tipit perëndimor në Shqipëri, larg diktaturave dhe pushtimeve. Këtë rol e ka luajtur emigracioni shqiptar në kohën e Zogut kryesisht në Jugosllavi, Austri dhe Amerikë. Në kohën e pushtimit fashist dhe nazist të Shqipërisë, roli i diasporës ka qenë deri diku i pandjeshëm. Me vendosjen e regjimit komunist në vendin tonë, diaspora në vendet e Evropës Perëndimore dhe në Amerikë është mobilizuar për demokratizimin e Shqipërisë, dhe ka dhënë kontribute të mëdha.

Mbas vitit 1990, diaspora ka shkëlqyer për sa i përket problemit të bashkimit kombëtar. Për çlirimin e Kosovës kanë dhënë kontribut të pasqorë dhe janë mbledhur fonde të mëdha financiare në ndihmë të luftës në Kosovë, të njohura si kontributi i 3 përqindëshit. Edhe ardhja e shqiptarëve nga emigracioni për të marrë pjesë në luftën çlirimtare të Kosovës, është një shfaqje brilante që do të mbetet e paharruar në historinë e saj. Krijimi i Batalionit Atlantik me efektiv tërësisht nga diaspora i nderon në jetë të jetëve ata që lanë punën fitimprurëse dhe familjet në emigracion në vendet perëndimore dhe Amerikë, dhe u radhitën në luftë çlirimtare, ku shumë prej tyre dhanë edhe jetën. Kjo do jetë në jetë të jetëve, nderi i diasporës!

# Përse burrat i tradhtojnë gratë?

Në çdo rast dhe kudo, dëgjojmë tradhti bashkëshortore. Nga burrat dhe gratë por, kryesisht nga burrat. Miliona njerëz, meshkuj dhe femra, janë ndëshkuar, dhunuar, kanë humbur edhe jetën, për tradhti bashkëshortore, dhe ajo nuk ndalet. Në asnjë vend dhe në asnjë kulturë.

Presidentë, kryeministra, ministra, politikanë, VIP-a, dhe... meshkuj të të gjitha kategorive, e kanë provuar ose ëndërrojnë ta provojnë gruan e huaj në krevat.

Ndoshta do të duhet kohë që njerëzimi të harrojë aferën e presidentit të Amerikës, Bill Clinton me praktikanten e Shtëpisë së Bardhë, Monika Lewinski. Ky nuk është rasti i parë, i njohur, nga personalitetet e botës.

Helmuth Schmidt (1918-2015), njëri ndër bundeskancelarët më të suksesshëm të Gjermanisë, njëkohësisht njeriu model në jetën bashkëshortore me gruan e tij Loki, e ka kryer aktin e tradhtisë bashkëshortore. Në një konferencë shtypi, kur ai ishte bundeskancelar, një gazetar e pyeti „E keni tradhtuar ndonjëherë gruan“?

Ai u përgjigj: „Moral im dhe posti që unë mbuloj, e përjashtojnë gënjeshtëri. Po, e kam bërë edhe unë atë punë muti por, vetëm një herë“.

Mund të mendohet shikuese shifra e burrave që shkojnë me gratë e huaja. Sipas studimeve të ndryshme, rreth 79 për qind e burrave, të paktën një herë, e kanë tradhtuar gruan. Mendohet se, 13 për qind e meshkujve, e kanë tradhtuar bashkëshorten, me gruan e shokut të tyre të ngushtë.

Në Gjermani, çdo ditë shkojnë në bordello, rreth 1,5 milion meshkuj.

Përse ndodh kjo!? Përse meshkujt janë seksualisht, kaq të papërmbytur!

Sipas hulumtimeve të bëra nga specialistët psikologë në këtë fushë, arsyet janë disa.

Psikologu dhe filozofi Giulio Cesare Giacobbe, sqaron: “Në princip, çdo martesë do të duhej të ishte rreptësisht monogami, por nuk është. Prandaj kam thënë se, martesë është në kundërshtim me natyrën. Sepse burri, pandryshuesmërisht, është i programuar nga natyra poligam. Kjo është pjesë e instinkteve të tij. Ashtu si dhe instinkti i gruas, për të lindur dhe rritur fëmijë. Besnikëria e partnerit nuk mund të detyrohet. Detyrimi i besnikërisë seksuale është akt dhune...”

„Unë jam skllav i instinktit seksual. Kjo është në gjenin tonë mashkullor. Burrat janë programuar të tillë, si shpërndarës sperme te sa më shumë gra, për të siguruar mbijetesën e species njerëzore. Një mashkull që nuk mendon jashtë krevatit të vet martesor, ose është i programuar gabim ose, është i sëmurë. Normal nuk është“, mendon një “Don Zhuan”.

Në shumë vende të botës, edhe sot, më së shumti në botën islame, poligamia është ligjrisht e lejuar. Themeluesi i Arabisë Saudite, Abad al Aziz ibn Saud (1875-1953), njihet si poligami më i madh në botën islame. Ai kishte 24 gra, të njohura zyrtarisht, dhe 81 fëmijë.

Në shumë vende perëndimore, tradhtia

bashkëshortore, edhe kur është e provuar dhe e vërtetuar, nuk njihet juridikisht si shkak për prishjen e martesës.

Meshkujt, biologjikisht janë programuar si, prodhues dhe shpërndarës sperme. Kjo do të thotë që, detyra e tyre primare është, shpërndarja e spermës te sa më shumë femra, për të siguruar vazhdimësinë e species njerëzore. Këtë e bëjnë



të gjitha gjallesat mashkullore.

Edhe femrat „vuajnë“ nga instinkti seksual por, reagojnë komplet ndryshe. Ato, diku në mekanizmin e ndjenjave, kanë një „bllokues“. Nëse nuk hapet bllokuesi, nuk shkojnë drejt burrave të huaj. Ato kalojnë nga ndjenja tek veprimi. Nëse nuk e ndiejnë, nuk e bëjnë. Te meshkujt mungon një mekanizëm i tillë. Ata e bëjnë edhe pa ndier gjë fare. Tipik ka qene Giacomo Casanova (1725-1798).

Ai ishte frekuentues i rregullt në bordello. Gjithandej takonte gra që e hyjnizonin dhe i dorëzoheshin vullnetarisht. Më vonë ai tregonte se, kishte kryer marrëdhënie seksuale me 122 gra, nga të shoqërisë së lartë, shërbyese, murgës, aktore. Për të gjitha ato, ai nuk kishte ndier asgjë, kurrë. Shpesh ndodhej para martesës por, në raste të tilla, gjithnjë arratisesh nga qyteti.

Duket se burrat, me kalimin e kohës, e humbasin interesin seksual me të njëjtën grua. Pas një viti marrëdhënieje me të njëjtën grua, interesi seksual i mashkullit zbret deri në 50 për qind, në krahasim me muajin e mjalit. Zbritja vazhdon, gjithnjë e më shumë me kalimin e kohës.

Ky efekt, ndoshta do të kuptohej shumë më mirë, duke marrë për bazë reagimet mashkullore, nga bota shtazore.

Nëse do të merret një ka, dhe do të dërgohet te lopa që kërkon ka, ai në fillim do të ndihet shumë mirë, dhe menjëherë do të mundohet t'i tregojë asaj, aftësitë e veta mashkullore. Nëse kau do të bie në kontakt me lopë të tjera, ai do të tregojë po të njëjtat aftësi, por nëse do të jetë në stallë, vazhdimisht me të njëjtën lopë, aftësia e tij seksuale bie. Në botën shtazore, tek meshkujt, aftësia seksuale me femra të ndryshme, të llojit të njëjtë, mbetet konstante, si me të parën dhe...me të

dymbëdhjetën.

Sipas studiuesve, shkak është substanca kimike, e quajtur DOPAMINË.

Eksperimentet kanë treguar se, te minjtë meshkuj, kur ata janë vetëm me „bashkëshorten“ e tyre, sasia e dopaminës në gjak, ulet shumë. Sapo ata shikojnë një „damë“ të re, dopamina shpërthen furishëm në gjak. Kështu funksionon edhe

truri i mashkullit njeri, sqaron psikologu.

Shkencëtarët i kanë vënë një emër këtij fenomeni, Coolidge-effekt, sipas një anekdote të presidentit amerikan, Calvin Coolidge (1872-1933). Ai, bashkë me gruan e tij, shkoi për vizitë në një fermë bujqësore. Gruaja e tij, siç duket, u bë kurioze ndaj një gjeli, i cili u „kërceu“ me radhë, disa pulave. Kur dikush i tregoi se gjeli këtë punë bën deri në dymbëdhjetë herë në ditë me pulat, ajo u përgjigj: “Thuajani, mundësisht, burrit tim, z. president”.

Kur presidenti u informua mbi potencialin seksual të gjelit, ai u përgjigj: „Desha të di nëse gjeli e bënte këtë gjë me të njëjtën pulë, apo me pula të ndryshme“?

Kur u sigurua se gjeli, çdo herë e bënte me pula të ndryshme, ai vazhdoi: “Thuajani këtë gjë gruas time”!

Psikologu kanadez, Dennis F. Fiorinio, ka zbuluar bazën biokimike të kësaj dukurie. Ai mendon se, dëshira seksuale, është e fshehur diku, në thellësitë e trurit të mashkullit. Kjo zonë „alarmi“, e fshehur diku te sistemi limbik, përbëhet nga një sistem nervor i posaçëm. Kur mashkulli, njerëzor apo shtazor, e shikon damën e huaj, qelizat nervore informojnë menjëherë qendrat e prodhimit të „drogës“ dopaminë, e prodhojnë atë, dhe e lëshojnë në gjak.

Që dopamina, e rritë në mënyrë të menjëhershme dëshirën seksuale, kjo është vërtetuar shkencërisht nga studiuesit biopsikologë. Në rastet e kontakteve të minjve meshkuj, të mbyllur në kafaz, menjëherë në kontakt me damën e re, sasia e dopaminës ka shkuar deri në 90 %. Pas kontaktit seksual, është ulur deri në dhjetë për qind.

Te bota mashkullore, midis progra-

mimit biologjik seksual të meshkujve, dhe moralit, ekziston një hendek i madh. Programimi i nxit, morali i frenon, nuk i lejon. Por, pushteti i moralit, duket se është shumë i dobët para pushtetit të programimit seksual natyror. Instinkti seksual, as nuk vritet, as nuk burgoset.

A janë në gjendje meshkujt që ta kontrollojnë instinktin seksual?

Përgjigjja është, po.

Pavarësisht nga programimi, njeriu është në gjendje që ta vë nën kontroll veten, në çdo rast dhe rrethanë. Për këtë, një rol të rëndësishëm, luan gruaja. Gruaja, me veprimet ose mos veprimet e saj, është një faktor i rëndësishëm për moralin e burrit.

Logjika ta thotë se, arsyeja kryesore që burrat i tradhtojnë gratë, nuk është vetëm instinkti seksual, por dëshira për të gjetur te dikush tjetër, atë që iu mungon në partneritet.

„Pas katër vjet martese, e tradhtova gruan. Shkova me një shoqe të punës. Jo se ajo ishte më e bukur se gruaja ime. Përkundrazi, e imja ishte shumë më e bukur. Arsyeja ishte se, tek ajo, gjeta diçka tjetër, diçka që i mungonte gruas time, dhe sigurisht që nuk do ta arrinte kurrë.

I mungonte femërorja, delikatesa e femrës. Kolegeje e punës, ishte e brishtë, plot kreativitet dhe fantazi. Dëshira për të qenë kudo dhe sa më gjatë me të, nuk më mbaronte kurrë. Nuk ka gjë më të vështirë se, kur në shtëpi, dëgjon të flitet vazhdimisht vetëm për paratë, borxhet, mobilet, fëmijët...“, tregon një 35 vjeçar, i cili pas gjashtë vitesh martesë, u nda me gruan.

„Natyrisht që e imagjinoj veten me një femër të bukur në krevat, si nga ato që i njoh dhe ato që nuk i njoh, por nuk e kam bërë kurrë dhe as që kam ndërmend ta bëj një gjë të tillë. Njoh shumë burra, të cilët për një marrëzi me një të huaj, kanë shkatërruar familjen. Prandaj e pyes veten, përse duhet të rrezikoj kot?“, mendon një dyzet vjeçar i martuar.

Megjithatë, burrat nuk heqin kollaj dorë nga e huaja.

Mënyra më e mirë, për ta parandaluar burrin nga tradhtia, është që gruaja të sillet me të, ashtu siç do të dëshironte që ai, të sillej me gruan.

Nëse gruaja dyshon se burri është në rrugën e tradhtisë, ose e ka kryer aktin, nuk është koha për t'u grindur. Kontrolli i telefonit të dorës, apo xhepave, për një adresë apo një copë letër me ca fjalë dashurie, është mënyra më e gabuar. Edhe vëzhgimi i burrit, apo tendenca për ta mbyllur në shtëpi, është marrëzi fëmijërore. Është momenti që ajo t'i krijojë burrit, atmosferën e duhur, brenda familjes, sa nuk është vonë.

Arma më e fuqishme për ta çarmatosur burrin, është lavdërimi. Më shumë përqaftime, më shumë puthje, më shumë përkëdhelje, më shumë romantikë, dhe sa më pak, ose aspak brutalitet. Burrat në përgjithësi nuk e durojnë dot brutalitetin. Të gruas, jo se jo.

**Lekë Imeraj**  
shkrimtar, përkthyes, publicist

# AUTIZMI (TSA), SHENJAT, MARRJA NËN KUJDES DHE IDET E MARRURA

Njëherazi të izoluar nga bota e jashtme dhe shumë të ndjeshëm ndaj variacioneve (ndryshimeve) të vogla, personat e prekur nga turbullimet e spektrit të autizmit (TSA), janë të shënuar për ide të përcaktuara dhe të pakuptimta. TSA rezulton kryesisht me anomali zhvillimi të trurit para dhe pas lindjes. Shumica me origjinë gjenetike, por këto anomali mund jone po ashtu të ardhura për shkaqe ambientale. Në Francë, një nga vendet më të zhvilluara të botes ka 700 000 persona me autizem sipas vlerësimit të Inserm. Shfaqjet e TSA--persona njëherazi të izoluar dhe të ndjeshëm ndaj botes së jashtme kane vështirësi të vendosin ndërveprim social dhe komunikim me ane të sjelljes, gjuhës trupit, me lëvizje, pra me gjeste. Ata paraqesin anomali sjellje në veçanti me heshtje dhe ngurrime ndaj ndryshimit ose dhe një tendence përsëritje (perseveracione) të të njëjtës sjellje ose diskutimi. Ata ngjasojnë si të izoluar si në botën e brendshme, por mundet në mënyrë paradoksale të jene shumë të ndjeshëm ndaj ambientit--drita, kontakti fizik ose disa anomali, ku mund të shpërthejnë reagime shume të forta. -Autizmi (dhe TSA në përgjithësi) shfaqet gjate fëmijërisë së hershme, para moshës 3-vjeç, pastaj persiston gjate dhe deri gjithë jetën. Një depistim mund të behet dhe është esencial sa më herët të merret nen kujdes aq më të mira do të jene rezultatet. Disa sjellje që duhet të bëjnë të dyshosh për veshët - nëse fëmija është shumë i qete ose përkundrazi shumë i agjitur, që ngjason si indiferent ndaj ambientit, zhurmave apo personave që e rrethojnë. Nuk përgjigjen kur i thërret në emër ose rigojnë pak. Nuk të vështron në sy, nuk luan, nuk guget (gugu foshnjore) nuk drejton gishtin (sepse fëmijët drejtojnë gishtin) dhe nuk imiton të rriturit.

TSA ka një raport 4:1 në favor të djemve, pra meshkujt janë më të prekur se femrat, por kjo shifër duhet të merret relative sepse vlerësimet për këto turbullime janë ba më shumë në popullimin e djemve, dhe kesisoj mund që të fshihen, ose të kamuflohen shifrat e femrave. Sipas INSERM të dhënat e marra më herët kane dhëne një raport 3:1 në favor të djemve, raport i cili duket se evulon me përparimin e zbulimeve.

Shkaqet TSA janë, gjenetike kryesisht, por ka mundësi dhe ambientale, dihet shumë qarte se autizmi është i lidhur me një turbullim zhvillimi shumë të hershem të bebes në sistemet e nder komunikimit

dhe të ndërveprimit gjate zhvillimit të trurit dhe jo me një paafësi të prindërve për të ndërveprues me fëmijën e vet shpjegon prof. Frederique Bonnet (Tours-inserm). Sot janë emëruar të paktën 800 gene, që



janë mutante (të ndryshuara) tek autiket, shumica e të cilëve kodant për proteinat që marrin pjese në formimin e sinapseve, që lejojnë komunikimin midis neuroneve shpjegon Ferderic Loumonnier. Po ashtu faktorët ambiental gjate shtatzënisë si ekspozimi ndaj viruseve, marrja e disa lloj ilaçesh në shtatzëni shton rrezikun për fëmijë autike. Sipas të dhënave të



marrura: gluteni, vaksinat ose sjellja e prindërve a provokon autizem??- të dhënat e disponueshme aktualisht, pa-

varësisht disa këmbënguljeve hamendesuese-as sëmundja e celiakis sekondare nga mos durimi (intolerance) ndaj glutenit e as vaksinimi kundër fruth-parotit-ru-beol (FRP), as karakteristikat e prindërve

të pretenduara për nenat e ftohta nuk do të ndërvepronin me fëmijët dhe nuk janë faktor rreziku i TSA-s.

TSA dhe invaliditeti -:

Një aspekt i sjelljeve të veçanta të personave të prekur nga autizmi kane shpesh origjinë në memorien e vështirë dhe në vështirësinë e futjes në (inserim social) që me gjithë ndryshimet e tyre e bëjnë

patologjitë gjenetike me handicap intelektual të rende si vonës mendore e lidhur me sindromin X fragjil, ose në mënyrë tranzitore me sindromin RETT. Tek pacientet e prekur me TSA me deficit intelektual, në ekzaminimet mjekësorë duhet të behën në mënyrë sistematike.

Disa ide të marrura si përfundim: të lidhura me vonësën intelektuale nga e kundërta e ideve të përhapura, nuk është autizmi i lidhur në mënyrë sistematikë me vonësën intelektuale, p.sh. sindromi Asperger është një TSA me një zhvillim shumë të mirë intelektual, megjithatë 1/3 e personave kane një TSA persistente me diferencim intelektual të gravitetit krejt të ndryshëm.

Marrja nen kujdes nuk nënkupton trajtim por një ndjekje gjate gjithë jetës.

Për autiket duhet të kujdesemi, dhe të kemi kujdes të përshtatshëm, çdo fëmijë për të përmirësuar aftësitë funksionale, për të nder epuar me botën rrethuese dhe ta adaptojmë atë. Llojet e ndryshme të ndërhyrjes bëjnë që të përmirësohen simptomat e TSA-s si riedukimi funksional shumë i hershem i komunikimit. Kjo e fundit lejon evolimin shumë pozitiv duke ndjek shkollën përkatëse dhe më vonë atë profesionale duke sigurua një jete të kënaqshme sidomos tek 20% te fëmijëve 4-5 vjeç të cilët nuk e kane të zhvilluar gjuhen, objektivi është që ti japim atij në rrethin e vet mjete për të nder vepruar me të tjerët në mënyrë që të fitoj autonominë. Duhet thënë që fëmijët e prekur nga TSA nuk mund të ndjekun shkollat klasike. Një luftë aktuale është që të shkollohen autiket dhe ti fusim ato në shoqëri sa më herët dhe ti të kenë institucione të veçanta. Sido që një pakice e tyre nuk mund të inserohen në mënyrë sociale veç se në qendra të kujdesit te specializuar.

Testimimi i tyre për progres të konsiderueshëm të realizuar me masat e inteligjencës tek autiket ku është fjala për "inteligjence tjetër-të ndryshme", pra dallime cerebrale të dukshme dhe prej shumë kohesh më tepër ka orientim për njohjen e disa formave të autizmit, që më të shpeshtat nuk shoqërohen me kufizim intelektual thekson Laurent Mattron dhe Isabelle Soulieres Universiteti Quebec et Montreal-KANADA.

**Përgatiti Dr. Med. Ndue Nikaj,**

*me rastin e ditës botërore të autizmit*

autizmin një invalidët të njohur dhe në Francë qysh nga viti 1996.

Sindromi autik mund të observohet në

## REDAKSIA

Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**

Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:  
**PREKË E ZINA GJONAJ**

